



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 5 janar 2022
Nr.ref.:AGJ 1932/22

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI113/21

Parashtrues

Bukurije Haxhimurati

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Pml.nr.29/2021, të 13 prillit 2021

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesja e kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Bukurije Haxhimurati, me vendbanim në Doganaj, komuna Ferizaj, të cilën e përfaqëson Florin Vërtopi, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) Pml.nr.29/2021, të 13 prillit 2021, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) [PAKR.nr.623/2019], të 30 shtatorit 2020 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), [PKR.nr.484/2016], të 18 nëntorit 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesja pretendon të jenë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt), 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) si dhe nenet 8, 10 dhe 12 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e më tejme: DUDNJ).
4. Parashtruesja e kërkesës po ashtu kërkon që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) të nxjerrë masën e përkohshme për pezullimin e zbatimit të vendimeve të lartcekura, *“sepse një zbatim i këtyre aktgjykimeve të cilat konsiderohen antikushtetuese do ta privonte parashtruesen nga liria dhe do ti shkaktonte dëme të pariparueshme për jetën dhe shëndetin e saj”*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 27 [Masa e përkohshme] dhe 47 [Kërkesa individuale], të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullave 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 56 [Kërkesa për masë të përkohshme], të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 11 qershor 2021, Gjykata pranoi kërkesën e parashtrueses së kërkesës.
7. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani morri detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

8. Më 8 korrik 2021, Kryetarja e Gjykatës Gresa Caka-Nimani caktoi gjyqtaren, Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gerxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).
9. Më 13 korrik 2021, Gjykata njoftoi parashtruesen e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
10. Më 27 korrik 2021, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore dosjen e plotë të rastit.
11. Më 28 korrik 2021, Gjykata pranoi dosjen e plotë të rastit nga Gjykata Themelore.
12. Më 22 shtator 2021, Gjykata shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe vendosi që rasti të shqyrtohet sërish në një seancë të ardhshme.
13. Më 20 dhjetor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.
14. Në të njëjtën ditë, Gjykata vendosi njëzëri se kërkesa është e pranueshme; si dhe të konstatojë se (i) ka pasur shkelje të nenit 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (ii) nuk ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (iii) Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Pml.nr.29/2021, i 13 prillit 2021, mbetet në fuqi; si dhe (iv) refuzoi kërkesën për masë të përkohshme.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 24 shkurt 2014, Prokuroria Speciale e EULEX-it (në tekstin e mëtejshëm: Prokuroria Speciale) lëshoi Aktvendim për Fillimin e Hetimeve ndaj parashtrueses së kërkesës dhe disa personave të tjerë, pasi ekzistonte dyshimi i bazuar se parashtruesja e kërkesës ishte përfshirë në kryerjen e veprave penale nga paragrafi 2 i nenit 428 [Marrja e ryshfetit] dhe paragrafi 1 i nenit 431 [Ushtrimi i ndikimit] të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 04/L-082 (në tekstin e mëtejshëm: KPRK), pasi parashtruesja e kërkesës mes viteve 2011 dhe 2013 në cilësi të personit zyrtar kishte marrë drejtpërdrejt për veten e saj dhe për kryes të tjerë të panjohur shumën prej 13.000.00 euro nga dëshmitari "C" në këmbim të lirit të këtij të fundit nga burgu apo zbutjen e dënimit të tij për të cilin ai ishte dënuar. Ajo gjithashtu dyshohej se kishte marrë nga dy persona të tjerë 500.00 euro të tjera.
16. Më 10 mars 2014, Gjykata Themelore në Prizren kishte lëshuar Urdhrin [PP.51/2014] ndaj parashtrueses së kërkesës dhe disa personave të tjerë "*Për masa të fshehta për përgjimin e telekomunikimeve dhe regjistrimin e thirrjeve*

telefonike duke përfshirë leximin retroaktiv të mesazheve tekstuale (SMS-ve)” duke autorizuar veprimet e më poshtme:

“1.Pergjimin e telekomunikimeve: në mënyrë specifike për të përgjuar, monitoruar, regjistruar transkriptuar të gjitha thirrjet telefonike, mesazhet me zë dhe mesazhet me tekst të bëra në ose nga numrat e telefonit të përmendura më poshtë pa dijeninë ose pëlqimin e personit që i nënshtrohet kësaj mase dhe për nxjerrjen e regjistrimeve të thirrjeve për numrat telefonik DHE

Regjistrimin: për përfshirje në mënyrë retroaktive të të gjitha thirrjeve hyrëse dhe dalëse dhe mesazheve tekstuale të bëra (SMS-eve), të dërguara dhe të pranuar nga te dyshuarit dhe personat tjerë, pos të dyshuarve nga 1 shtatori 2013 deri me tani për numrat e telefonit të përmendura më poshtë.”

17. Më 4 qershor 2014, Gjykata Themelore në Prizren përmes Urdhrit [PP. 51/2014] kishte autorizuar vazhdimin e përgjimeve të telekomunikimeve edhe për 60 ditë nga lëshimi i Urdhrit.
18. Më 18 shtator 2014, Gjykata Themelore në Prizren përmes Urdhrit [PP. 51/2014] kishte autorizuar vazhdimin e përgjimeve të telekomunikimeve edhe për 60 ditë nga lëshimi i Urdhrit.
19. Më 25 mars 2016, Gjykata Themelore në Prizren kishte autorizuar aplikimin e masës së fshehtë të fotografimit apo video vëzhgimit, monitorimin e fshehtë të bisedave dhe stimulimin e korrupsionit për sa i përket parashtrueses së kërkesës dhe të akuzuarve të tjerë, për 60 ditë nga lëshimi i Urdhrit.
20. Më 29 maj 2016, Gjykata Themelore në Prizren kishte autorizuar bastisjen në banesën e parashtrueses së kërkesës.
21. Më 31 maj 2016, Gjykata Themelore në Prizren kishte nxjerrë Urdhrit [PPS.8/2015] me të cilin dëshmitarit “C” i ishin caktuar masat mbrojtëse si dëshmitar i mbrojtur, ku parashihej mes tjerash se seancat gjyqësore në të cilat do të dëshmojë dëshmitari “C” do të jenë të mbyllura për publikun.
22. Më 3 qershor 2016, Prokuroria speciale kishte njoftuar mbrojtësin e parashtrueses së kërkesës si dhe vet parashtruesen e kërkesës së dëshmitari “C” do të japë dëshmi më 9 qershor 2016, duke i njoftuar se mospjesëmarrja në seancës e dëshmisë së dëshmitarit “C”, pa një arsytim, e parandalon parashtruesen e kërkesës që të kundërshtojë pranueshmërinë e dëshmisë në fazën e shqyrtimit penal.
23. Më 7 qershor 2016, mbrojtësit e parashtrueses së kërkesës kishin bërë kërkesë për fotokopjimin e të gjitha shënimeve, dosjeve dhe pjesëmarrjen në të gjitha fazat e hetimeve lidhur me parashtruesen e kërkesës.

24. Po atë ditë, mbrojtësit e parashtrueses së kërkesës kishin paraqitur kundërshtim lidhur me Urdhrin e Gjykatës Themelore në Prizren [PPS. 8/2015] për caktimin e masave mbrojtëse ndaj dëshmitarit “C”.
25. Më 26 gusht 2016, Prokuroria Speciale e EULEX-it (në tekstin e mëtejshëm: Prokuroria Speciale) kishte ngritur aktakuzë [PPS.nr.8/2015] kundër parashtrueses së kërkesës për shkak të veprës penale nga paragrafi 2 i nenit 428 [Marrja e ryshfetit] dhe paragrafi 2 i nenit 431 [Ushtrimi i ndikimit] të KPRK-së si dhe ndaj personit B.V. për shkak të veprës penale nga paragrafi 3 i nenit 429 [Dhënia e ryshfetit], dhe paragrafi 2 i nenit 431 [Ushtrimi i ndikimit] të KPRK-së. Parashtruesja e kërkesës akuzohej se në cilësi të personit zyrtar ka marrë për vete dhe për kryes të tjerë të panjohur, shumën prej 13.000 euro nga dëshmitari “C”, në këmbim të lehtësimit të lirimit nga burgu apo për zbutjen e dënimit të këtij të fundit. Ajo gjithashtu akuzohej se nga dy persona kishte marrë shumën prej 500.00 euro.
26. Së bashku me aktakuzën e lartcekur parashtrueses së kërkesës i ishin dorëzuar 8 (tetë) CD me prova lidhur me rastin.
27. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesja e kërkesës dhe B.V. kishin paraqitur kërkesë për hedhjen e aktakuzës. Parashtruesja e kërkesës mes tjerash pretendonte se marrja e SMS-vë në mënyrë retroaktive përmes Urdhrit [PP.51/2014] të datës 10 mars 2014, të Gjykatës Themelore është bërë në shkelje të nenit 92 [Urdhrat për masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit] të KPPRK-së, që përcakton se përgjimi lejohet për 60 ditë nga data e lëshimit të urdhrit, të nenit 36 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ dhe kishte kundërshtuar dëshmitë e dëshmitarit “C”, si dhe disa dëshmi dhe prova të tjera.
28. Më 23 dhjetor 2016, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PKR.nr.484/2016] kishte refuzuar kërkesat për hedhjen e aktakuzës. Lidhur me marrjen e SMS-vë në mënyrë retroaktive, Gjykata Themelore kishte arsyetuar se dispozitat e KPPK-së që rregullojnë çështjen e përgjimeve nuk e ndalojnë marrjen e SMS-vë në mënyrë retroaktive. Gjykata Themelore arsyeton se një konkluzion i tillë mbështet edhe në nenin 68 [Ruajtja dhe administrimi i të dhënave personale për qëllime të ndjekjes penale] të Ligjit Nr.04/L-109 për Komunikimet Elektronike (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Komunikime Elektronike), andaj sipas tyre, një gjë e tillë nuk është kundërligjore dhe në rastin konkret këto prova janë marrë sipas Urdhrit që është nxjerrë në harmoni me ligjin.
29. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesja e kërkesës kishte paraqitur ankesë ndaj Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, të 23 dhjetorit 2016, duke ngritur sërish çështjen e SMS-va të marrë në mënyrë retroaktive dhe duke kërkuar veçimin e dëshmimeve të dëshmitarëve, duke përfshirë dëshmitarin “C”.
30. Më 16 janar 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PN.nr.22/17] kishte refuzuar ankesën e parashtrueses së kërkesës ndaj Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore të 23 dhjetorit 2016, duke konfirmuar arsyetimin e Gjykatës Themelore lidhur me SMS-ët retroaktivë ndërsa lidhur me kundërshtimin e

dëshmime të dëshmitarëve përcaktoi se këto dëshmi parashtruesja e kërkesës mund t'i kundërshtojë edhe në faza të mëvonshme të procedurës –gjatë shqyrtimit gjyqësor.

31. Më 18 nëntor 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), përmes Aktgjykimit [PKR.nr.484/2016], shpalli fajtor parashtruesen e kërkesës për veprën penale nga neni 431 [Ushtrimi i ndikimit] i KPRK-së dhe i shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, dhe e liroi nga akuza për veprën penale nga paragrafi 2 i nenit 428 [Marrja e ryshfetit] të KPRK-së. Ndërsa B.V. u shpall fajtor për veprën penale nga neni 431 [Ushtrimi i ndikimit] të KPRK-së dhe u lirua nga akuza për veprën penale nga paragrafi 3 i nenit 429 [Dhënia e ryshfetit] të KPRK-së. Mes provave tjera të administruara nga Gjykata Themelore bazuar në të cilat parashtruesja e kërkesës ishte shpallur fajtores, duke përfshirë transkriptet e përgjimeve, dëshmitë e dëshmitarëve si dhe provat e mbledhura nga vëzhgimi e monitorimi i fshehtë i bisedave, në seancë shqyrtuese gjithashtu ishte lexuar edhe dëshmia e dëshmitari "C", i cili nuk kishte qenë prezent në shqyrtim kryesor, pasi i njëjti kishte statusin e dëshmitarit të mbrojtur.
32. Ndaj Aktgjykimit [PKR.nr.484/2016] të Gjykatës Themelore të 18 nëntorit 2019, ankesa kishin paraqitur: Prokuroria Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Themelore), parashtruesja e kërkesës dhe personi B.V., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit për dënimin. Parashtruesja e kërkesës po ashtu kishte paraqitur përgjigje në ankesën e Prokurorisë Themelore me propozimin që e njëjta të refuzohet si e pabazuar. Prokuroria e Apelit e Kosovës (në tekstin e mëtejme: Prokuroria e Apelit) kishte propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore të aprovohet ndërsa ankesat e parashtrueses së kërkesës dhe e B.V. të refuzohen si të pabazuara. Parashtruesja e kërkesës mes tjerash pretendoi para Gjykatës së Apelit se urdhëresa për përgjim e datës 10 mars 2014, ka qenë e kundërligjshme pasi ka urdhëruar përgjime retroaktive të mesazheve tekstuale dhe kjo edhe në shkelje edhe të së drejtës për jetë private të garantuar me nenin 36 të Kushtetutës. Ajo gjithashtu u ankua lidhur me statusin e dëshmitarit "C" dhe pamundësinë që të marrë në pyetje këtë dëshmitar gjatë procedurës penale.
33. Më 30 shtator 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR.nr.623/2019], i refuzoi ankesat e paraqitura nga Prokuroria Themelore, parashtruesja e kërkesës dhe B.V. si të pabazuara. Mes tjerash, Gjykata e Apelit arsyetoi se nuk qëndron pretendimi se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore është i bazuar në prova të papranueshme pasi që Gjykata Themelore ka mbështetur Aktgjykimin në biseda të zhvilluara me dëshmitarin "C" më 30 mars 2016 dhe 24 prill 2016, gjatë të cilave takime parashtruesja e kërkesës kishte pranuar se nga dëshmitari "C" ka pranuar para. Gjithashtu, Gjykata e Apelit arsyetoi se nuk qëndron pretendimi i parashtrueses së kërkesës se asaj nuk i është dhënë mundësia të kundërshtojë dëshminë e dëshmitarit "C" pasi gjatë marrjes së tij në pyetje, kanë qenë të ftuar mbrojtja e parashtrueses së kërkesës dhe vet parashtruesja e kërkesës, me ç'rast mbrojtësit e parashtrueses së kërkesës edhe janë njoftuar se dëshmitari "C" është dëshmitar i mbrojtur por megjithatë, ata kanë lëshuar

seancën në të cilën është marrë në pyetje dëshmitari “C”. Në procesverbalin e takimit të 9 qershorit 2016, gjithashtu ekziston konstatimi se statusi i dëshmitarit “C” është “dëshmitar i mbrojtur –anonim”. Gjykata e Apelit lidhur me provat që ishin marrë për bazë për shpalljen fajtores të parashtrueses së kërkesës theksoi se, për shpalljen fajtores të parashtrueses Gjykata Themelore ishte bazuar edhe në transkriptet e takimit të zhvilluar në mes të parashtrueses së kërkesës dhe dëshmitarit C, biseda të zhvilluara më datë 30 mars 2016 dhe 24 prill 2016 gjatë të cilave takime parashtruesja e kërkesës kishte pranuar se nga dëshmitari C ka pranuar shuma të caktuara të parave, si dhe raportet e përgjimeve të datave 31 maj 2016 dhe 1 qershor 2016.

34. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesja e kërkesës dhe B.V., kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [PKR.nr.484/2016] dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [PAKR.nr.623/2019], paraqitën kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe zbatimit të gabuar të ligjit penal me kërkesën që kërkesa të aprovohet dhe të denuarit të lirohen nga akuzat ose që rasti të kthehet në rigjykim në Gjykatën Themelore. Parashtruesja e kërkesës para Gjykatës Supreme pretendoi, mes tjerash, se: (i) nuk i është mundësuar qasja në të gjitha materialet gjatë fazës hetimore; (ii) Aktgjykimi i Gjykatës Themelore është mbështetur në prova të papranueshme (SMS që janë nxjerrë në mënyrë retroaktive) duke rezultuar kështu edhe në shkeljen e privatësisë të parashtrueses së kërkesës në kundërshtim me nenin 36 të Kushtetutës; dhe (iii) statusi i dëshmitarit “C” nuk është qartësuar; dhe, se asaj nuk i është mundësuar që të marrë në pyetje dëshmitarin “C” në mënyrë që të kundërshtojë deklaratën e tij duke shkelur kështu parimin e barazisë së armëve.
35. Më 13 prill 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [PML.nr.29/2021] refuzoi kërkesat e parashtrueses së kërkesës dhe atë të B.V. për mbrojtje të ligjshmërisë, si të pabazuara. (i) Sa i përket pamundësisë për të marrë në pyetje dëshmitarin “C”, Gjykata Supreme theksoi se ky pretendim është i pabazuar pasi në ditën që dëshmitari “C” është dëgjuar më 9 qershor 2016, kanë qenë prezent edhe mbrojtësit e parashtrueses së kërkesës me ç’rast janë njoftuar se dëshmitari “C” ka statusin e dëshmitarit të mbrojtur, por mbrojtësit e parashtrueses së kërkesës janë larguar nga seanca me arsyetimin se dëshmitarit nuk i dihet statusi, andaj, deklarata e dëshmitarit “C” vetëm është lexuar në seancën shqyrtuese dëgjimore. Gjithashtu Gjykata Supreme arsyetoi se kjo dëshmi nuk ka qenë vendimtare për nxjerrjen e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe për të vërtetuar se parashtruesja e kërkesës e ka kryer veprën penale për të cilën është dënuar. (ii) Sa i përket pretendimit se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore është bazuar në SMS-të që janë nxjerrë në mënyrë retroaktive, Gjykata Supreme gjeti se ky fakt qëndron por sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme kjo nuk ka pasur ndikim në marrjen e vendimit ngase gjykata gjendjen e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë me të gjitha provat e tjera të administruara. (iii) Sa i përket pretendimit se parashtrueses së kërkesës nuk i janë dhënë shkresat e lëndës gjatë fazës së hetimit, Gjykata Supreme theksoi se konform neni 213, paragrafi 5 të KPPK-së, koha kur mbrojtja medoemos duhet të pranojë shkresat e lëndës është koha kur është ngritur aktakuza, dhe një gjë e tillë ka ndodhur në rastin konkret.

36. Bazuar ne shkresat e lendes, në momentin e paraqitjes së kërkesës në Gjykatë, parashtruesja e kërkesës ishte në pritje të ekzekutimit të dënimit.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

37. Parashtruesja e kërkesës pretendon para Gjykatës se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [PML.nr.29/2021], lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [PAKR.nr.623/2019], dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [PKR.nr.484/2016], shkel të drejtat e saj të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës, në lidhje me nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt), 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ, si dhe nenet 8, 10 dhe 12 të DUDNJ.

38. Parashtruesja e kërkesës më specifikisht pretendon se: *i)* nuk i ishte mundësuar të ketë në posedim dosjen e lëndës nga Prokuroria Speciale dhe gjyqtari i procedurës paraprake, gjatë fazës hetimore dhe kjo në shkelje të parimit të barazisë së armëve dhe të parimit të kontradiktoritet; *ii)* edhe pse kishte kundërshtuar nxjerrjen e urdhrin për caktimin e masave mbrojtëse për dëshmitarin "C", kjo kërkesë e parashtrueses së kërkesës nuk është përfillur duke pamundësuar marrjen e tij në pyetje nga parashtruesja e kërkesës; *dhe iii)* aktgjykimet e kontestuara bazohen në prova të cilat janë të papranueshme ligjërisht, konkretisht në SMS, të nxjerrë në mënyre retroaktive duke shkelur kështu edhe të drejtën e parashtrueses së kërkesës për privatësi dhe jetë private.

(i) Lidhur me pamundësinë e qasjes në dokumente të lëndës nga Prokuroria Speciale dhe gjyqtari i procedurës paraprake, gjatë fazës hetimore

39. Në këtë kontekst, parashtruesja e kërkesës pretendon se është përballur me prova të cilat nuk ka pasur mundësi t'i kundërshtojë gjatë fazës hetimore, duke shtuar se vetëm në rastin e dorëzimit të aktakuzës në Gjykatën Themelore, Prokuroria Speciale i ka dorëzuar mbrojtjes së parashtrueses së kërkesës 8(tetë) CD me çka vërtetohet edhe fakti se në fazën e hetimeve, parashtrueses i ishte mohuar mundësia që të ketë qasje në dosjen e saj. Kjo sipas saj është në kundërshtim me nenin 7 [Detyrimi i përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve], paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPK-së) duke shtuar se "*i pandehuri në cilëndo fazë të procedurës ka të drejtë të mbrohet duke i shfrytëzuar faktet si dhe provat të cilat janë siguruar nga Policia apo Prokuroria, në mënyrë që pas një analize detale të provave dhe fakteve, të mund të propozoj nxjerrje të provave konkrete.*" Për më tepër ajo shton se Neni 9 [Barazia e palëve] i KPPK, e obligojnë Prokurorin që mbrojtjes të ia dorëzon të gjitha shkresat e dosjes, me arsye që të respektohet parimi i "barazisë e palëve" si dhe i pandehuri të ketë mundësi në mbrojtje efektive. Neni 61 [Të drejtat e mbrojtësit si përfaqësues i të pandehurit] par.3 i KPPK, siguron dhe i jep garanci të plota mbrojtjes që ai të njoftohet me kohë për

vendin dhe kohen e zbatimit te veprimeve hetimore, të marrë pjesë në to dhe të shikoj shkresat dhe provat e çështjes.

40. Parashtruesja thekson se këto parime, i mbron edhe Kushtetuta si dhe KEDNJ. Parashtruesja e kërkesës mbështet argumentet e saj duke u thirrur edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ).
41. Në këtë kontekst, ajo thekson së në rastin *Kuraliq kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, në paragrafin 44 theksohet mes tjerash se garancitë e nenit 6 të KEDNJ janë të vlefshme edhe para se lënda të dërgohet për gjykim. Parashtruesja thirret edhe në rastin e Gjykatës KI78/12 duke specifikuar paragrafët që trajtojnë çështjen e parimit të barazisë së armëve ku kërkohet që secilës palë në procedurë të i jepet mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin e saj nën kushte që nuk e vendose atë në pozitë të disfavorshme në raport me palën tjetër, çështjen e dëshmitarëve e eksperteve dhe barrën e provës të prokurorit për të dëshmuar kryerjen e veprës penale. Lidhur me këtë parashtruesja po ashtu citon rastin e Gjykatës KI230/19, Aktgjykim i 8 janar 2021, dhe rastet e GJEDNJ-së të referuara aty.

(ii) *Lidhur me mos marrjen në pyetje të dëshmitarit “C” nga parashtruesja e kërkesës.*

42. Lidhur me dëshmitarin “C” parashtruesja thekson se janë dhënë dy dëshmi dhe një deklaratë para Prokurorisë Speciale por të cilat nuk mund të përdoren para trupit gjykues pasi nuk i është dhënë mundësi parashtrueses së kërkesës ose mbrojtësit të saj të marrë në pyetje dëshmitarin dhe të kundërshtojnë dëshmitë ashtu si kërkohet me KPPK, duke shtuar se është obligim ligjor që secilës palë duhet ti jepet mundësi që t’i shtrojnë pyetje dëshmitarit të pyetur nga pala tjetër. Duke u thirrur në nenin 242 [Procedura për ngritjen e aktakuzës], paragrafi 1 të KPPK-së, parashtruesja thekson se Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze te procedurës penale, Ashtu si parashihet edhe me nenin 31, paragrafi 4 të Kushtetutës dhe nenin 6. paragrafi 3. pika (c) të KEDNJ-së. Lidhur me këtë, parashtruesja citon edhe rastet e GJEDNJ-së, *Bricmont kundër Belgjikës* dhe *Vnidisch kundër Austrisë*.
43. Andaj parashtruesja mban qëndrimin se ajo nuk është sjellur nga arresti shtëpiak gjatë fazës hetuese, për të qenë prezent në marrjen në pyetje të dëshmitarit “C” dhe se dëshmitari “C” asnjëherë nuk është paraqitur në shqyrtim gjyqësor dhe se dëshmitë e këtij të fundit janë lexuar në shqyrtim gjyqësor. Kundërshtimet e parashtrueses së kërkesës për të mos u lexuar këto procesverbale nuk janë trajtuar drejtë nga asnjë instancë gjyqësore.
44. Për me tepër parashtruesja pretendon se ajo kishte propozuar shtatë (7) prova që të lexohen në shqyrtim gjyqësor që dëshmonin padrejtësitë që i ishin bërë lidhur me dëshmitarin “C”, duke përfshirë, kërkesën e Prokurorisë Speciale për

masa mbrojtëse, urdhrin për Masa Mbrojte lidhur me dëshmitarin “C”, kundërshtimin e Urdhrit nga parashtruesja e kërkesës dhe disa parashtrësja tjera të parashtrueses së kërkesës lidhur me rastin. Por as kjo kërkesë nuk është marrë parasysh nga gjykata e rregullta.

45. Andaj, parashtruesja mban qëndrimin se *“Të gjitha këto trajtime të detalizuara, lidhur me shkeljen e parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit si dhe mos vendosja për KUNDËRSHTIMIN për nxjerrjen e urdhrit të [Gjyqtarit të Procedurës Paraprake] te dt.31.05.2016, PPS.m.8/15 dhe mosvendosja për ANKESË kundër vendimit PPS.m.8/15 të konstatuar në procesverbal të dt.09.06.2016 drejtuar gjyqtarit të procedurës paraprake në Gjykatën Themelore në Prizren, argumentojnë fuqishëm se gjykata e faktit, Gjykata e Apelit, dhe Gjykata Supreme kanë shkelur”* dispozitat e KPPK dhe nenet 31 e 32 të Kushtetutës, nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së, si dhe nenet 8, 10 të DUDNJ.
46. Lidhur me dëshmitarin “C” parashtruesja e kërkesës gjithashtu thekson se janë shkelur dispozitat procedurale pasi në disa raste atij i referohen si dëshmitar, e në disa raste dëshmitar bashkëpunues, ndërkohë që statusi i dëshmitarit dhe dëshmitarit bashkëpunues sipas dispozitave ligjore dallon. Për me tepër, Parashtruesja pretendon se Prokuroria dhe gjyqtari i procedurës paraprake sipas procesverbaleve i kanë premtuar dëshmitarit se nuk do të këtë pasoja ligjore edhe nëse është i përfshirë në shkelje ligjore megjithëse sipas dispozitave në fuqi, Prokuroria dhe gjyqtari raportues nuk e kanë një mundësi ligjore që ta lirojnë personin e këtillë prej procedurës penale.
47. Parashtruesja e kërkesës thekson se përmes mbrojtësve e ka kundërshtuar masën mbrojtëse – anonimitetin e dëshmitarit “C” dhe ka ushtruar kundërshtim më 7 qershor 2016, *“por deri me sot nuk kemi pranuar vendim nga Kolegji shqyrtues i Gjykatës Themelore në Prizren”*.

(iii) Lidhur me provat të cilat parashtruesja i konsideron të papranueshme ligjërisht, konkretisht SMS të nxjerrë në mënyrë retroaktive

48. Parashtruesja e kërkesës pretendon se aktgjykimet bazohen në prova të papranueshme, si në SMS, të cilët janë nxjerrë në mënyrë retroaktive, sipas Urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake, fakt të cilin e njeh edhe Gjykata Supreme por që sipas Gjykatës Supreme nuk kanë pasur ndikim në ligjshmërinë e marrjes së vendimit. Kjo sipas parashtrueses dëshmon se Gjykata Supreme është pajtuar me mbrojtjen se në kundërshtim me ligjin, Kushtetutën e KEDNJ, janë cenuar edhe privatësia, respektivisht fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimit të parashtrueses së kërkesës, dhe se Gjykata Supreme duhet të kishte marrë vendim të veçantë lidhur me përjashtimin e këtyre SMS-ve të pranuar në mënyrë të kundërligjshme. Në këtë kontekst, ajo thekson se sipas nenit 91 të KPPK-së, përgjimet e telekomunikimeve mund të bëhen vetëm prej datës së lëshimit të urdhrit për një periudhë të caktuar kohore dhe i cili urdhër mund të përtërihet por nuk mund të lëshohet në mënyrë retroaktive. Andaj, parashtruesja mban qëndrimin se Urdhri PP 51/2014 i 10

marsit 2014, është në kundërshtim edhe me të drejtën për privatësi sipas nenit 36, paragrafi 3 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së, pasi përmes këtij urdhri janë nxjerrë SMS në mënyrë retroaktive për periudhën kohore prej datës 22 shkurt 2012 deri me 10 mars 2013. Ajo shton se e çdo person ka të drejtë që t'i respektohet jeta private dhe familjare, vendbanimi dhe letërkëmbimi dhe se ndërhyrja në ushtrimin e kësaj të dejtë mund të bëhet vetëm në shkallën e parashikuar me ligj.

49. Parashtruesja e kërkesës po ashtu pretendon se e drejta e privatësisë është mbrojtur dhe siguruar edhe me konventa të tjera duke u thirrur në Konventën për Mbrojtjen e Individëve me Procedimin Automatik të të Dhënave, të 28 janarit 1981 dhe duke u thirrur edhe në Direktivën 2002/59/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 12 korrikut 2002.
50. Ajo i referohet edhe Ligjit për Komunikimet Elektronike duke u thirrur në nenin 68 të tij, lidhur me ruajtjen dhe administrimin e të dhënave personale për qëllime të ndjekjes penale dhe ku theksohet se ruajtja e këtyre të dhënave duhet të bëhet vetëm për një vit dhe se ruajtja bëhet për hyrjet-daljet e SMS-ve të shkëmbyer por pa përmbajtje. Andaj, parashtruesja pretendon se përmbajtja e SMS-ve mund të ruhet vetëm për të ardhmen dhe atë prej ditës kur të lëshohet urdhri i gjykatës relevante.
51. Andaj, ajo mban qëndrimin se *"Neni 8 i KELDNJ, neni 36 i Kushtetutës [...], neni 12 i [DUDNJ] dhe dispozitat ligjore të lartpërmendura si dhe praktika gjyqësore, të cituara në këtë nënkapitull", vërtetojnë bindshëm se në kundërshtim me të gjitha këto, është bërë nxjerrja e SMS-ve në mënyrë retroaktive për periudhën kohore prej dt.22.02.2012 deri me dt.10.03.2013, e sipas urdhresës të kundërligjshme dhe antikushtetues të Gjyqtarit të Procedurës Paraprake, të GJTH në Prizren, PP 51/2014 i datës 10.03.2014, si dhe është bërë vëzhgimi i fshehtë fotografik dhe me video, monitorimi i fshehtë i bisedave dhe simulimi i veprës së korrupsionit sipas urdhrimit të kundërligjshëm dhe antikushtetues PPS. Nr. 8/15, PPR KR 52/14, të Gjykatës themelore në Prizren, i datës 25.03.2016 i lëshuar nga Gjyqtari i Procedurës Paraprake në GJTH në Prizren".*

Lidhur me kërkesën për masë të përkohshme

52. Parashtruesja e kërkesës kërkon vendosjen e masës së përkohshme, për të evituar dëmet e pariparueshme që mund t'i ndodhin parashtrueses së kërkesës nëse e njëjta dërgohet në vuajtje të dënimit me burgim, duke pasur parasysh që ajo vuan nga kanceri *"papillary thyroid carcionoma"*. Ekzaminimet e fundit mjekoligjore të cilat i ka bërë në muajin maj 2021, japin shkas dhe arsye se parashtruesja e kërkesës medoemos duhet të vazhdojë me terapi mjekësore dhe të ketë ndërhyje mjekësore. Ndërsa, më 22 mars 2021, parashtrueses së kërkesës i është refuzuar shlyerja e mëtutjeshme e ekzekutimit të dënimit. Gjithashtu, Gjykata e Apelit përmes aktvendimit [PN.nr.334/21] të 12 prillit 2021 ka refuzuar ankesën e parashtrueses së kërkesës ndaj vendimit të Gjykatës Themelore. Andaj, duke pasur parasysh gjendjen shëndetësore të parashtrueses

së kërkesës, kërkojnë nga Gjykata që të vendoset masa e përkohshme që parashtruesja e kërkesës të mos dërgohet në vuajtje të dënimit deri në kohën kur Gjykata të vendos lidhur me rastin.

53. Në fund, parashtruesja e kërkesës i propozon Gjykatës që:
- a) Të deklarojë kërkesën të pranueshme;
 - b) Të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31, 32 dhe 36 të Kushtetutës në lidhje me nenet 6, 8 dhe 13 të KEDNJ-së;
 - c) Të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [PML.nr. 29/2021], Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [PAKR.nr.623/2020], dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [PKR.nr.484/2016] që lidhet me pjesën për të cilin parashtruesja është shpallur fajtores, si dhe të kthejë rastin e saj për rishqyrtim në Gjykatën Themelore;
 - d) Të lejojë masën e përkohshme deri në kohën derisa të rivendoset nga Gjykata Themelore për çështjen sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Dispozitat relevante kushtetuese e ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1.Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2.Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...].

4.Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

Neni 36

[E Drejta e Privatësisë]

1. Çdokush gëzon të drejtën që t'i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera.

[...].

3. Fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimit tjetër, është e drejtë e pacenueshme. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm përkohësisht, në bazë të vendimit gjyqësor, nëse është e domosdoshme për ecurinë e

procedurës penale ose për mbrojtjen e vendit, në mënyrën e parashikuar me ligj
[...]

Neni 54 **[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]**

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6 **(E drejta për një proces të rregullt)**

1. *Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.*

[...]

3. *Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:*

[...]

d. *të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;*

Neni 8 **(E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)**

1. *Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.*

2. *Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.*

Neni 13 **(E drejta për zgjidhje efektive)**

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

KODI Nr. 04/L-123 I PROCEDURES PENALE

“Neni 7

Detyrimi i përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve

- 1. Gjykata, prokurori i shtetit dhe policia të cilët marrin pjesë në procedurën penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm.*
 - 2. Sipas dispozitave të parapara me këtë Kod, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia që marrin pjesë në procedurë penale detyrohen që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij, dhe para fillimit të procedurës dhe gjatë zhvillimit të saj t'i mundësojnë të pandehurit dhe mbrojtësit të tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të të pandehurit.*
- [...]*

Neni 9

Barazia e palëve

- 1. Nëse me këtë Kod nuk parashihet ndryshe, i pandehuri dhe prokurori i shtetit në procedurë penale kanë pozitë të barabartë.*
 - 2. I pandehuri ka të drejtë të deklarohet dhe atij duhet t'i lejohet deklarimi për të gjitha faktet dhe provat që e ngarkojnë dhe t'i paraqesë të gjitha faktet dhe provat që janë në favor të tij. Ai ka të drejtë që të kërkojë nga prokurori i shtetit të thërret dëshmitarë në emër të tij. Ai ka të drejtë t'i marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe të kërkojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta që vlejnë për dëshmitarët kundër tij.*
 - 3. I dëmtuari ka të drejtë dhe i lejohet të bëjë deklaratë për të gjitha faktet dhe provat që ndikojnë në të drejtat e tij dhe ka të drejtë për të bërë deklaratë mbi të gjitha faktet dhe provat. Ai ka të drejtë të marrë në pyetje dëshmitarët, t'u parashtojë pyetje të tërthorta dëshmitarëve të palës tjetër dhe të kërkojë nga prokurori i shtetit që të thirren dëshmitarët.*
 - 4. Nëse prokurori i shtetit vlerëson se gjatë hetuesisë janë mbledhur prova të mjaftueshme për të vazhduar në shqyrtim gjyqësor, prokurori i shtetit harton aktakuzën dhe paraqet faktet mbi të cilat ai e bazon aktakuzën dhe siguron provat për këto fakte.*
- [...]*

Neni 61

Të drejtat e mbrojtësit si përfaqësues i të pandehurit

[...]

3. Mbrojtësi ka të drejtë të njoftohet me kohë për vendin dhe kohën e zbatimit të veprimeve hetimore, të marrë pjesë në to dhe të shikojë shkresat dhe provat e çështjes në pajtim me dispozitat e këtij Kodi.

[...]

Neni 91

Personat kompetent për të urdhëruar dhe zbatuar masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit

1. Prokurori i shtetit mund të urdhërojë përkohësisht njërin nga masat e përcaktuara në paragrafin

2. të këtij neni vetëm në procedura penale urgjente, ose në procedura penale, të cilat janë duke u hetuar nën kapitullin XXIV ose kapitullin XXXIV të Kodit Penal, ose rasteve të shpëlarjes së parasë në raste të nevojshme, nëse pritja do të rezultonte nga lëshimi i urdhrit prej gjyqtarit të procedurës paraprake sipas paragrafit 2. të këtij neni do të rrezikonte sigurinë e hetimeve ose jetën dhe sigurinë e palës së dëmtuar, dëshmitarit, informatorit ose anëtarëve të familjes së tyre. Urdhri i tillë i përkohshëm pushon të ketë efekt nëse nuk konfirmohet me shkrim nga gjyqtari i procedurës paraprake brenda tri (3) ditëve nga lëshimi i tij. Me rastin e vërtetimit të urdhrit të përkohshëm të prokurorit të shtetit, gjyqtari i procedurës paraprake, sipas detyrës zyrtare, do të bëjë vlerësim me shkrim të ligjshmërisë së tij.

2. Gjyqtari i procedurës paraprake, me kërkesë të prokurorit të shtetit mund të urdhërojë secilën nga masat e mëposhtme:

- 2.1. fotografim të fshehtë ose vëzhgim me video në vende publike;
- 2.2. monitorim të fshehtë të bisedave në vende publike;
- 2.3. hetim të fshehtë;
- 2.4. regjistrimi i bisedave telefonike.
- 2.5. fotografim të fshehtë ose vëzhgim me video në vende private;
- 2.6. monitorim të fshehtë të bisedave në vende private;
- 2.7. kontrollim të dërgesave postare;
- 2.8. përgjim të telekomunikimeve, përfshirë tekstet e mesazheve ose mesazhet e tjera elektronike;
- 2.9. përgjim të komunikimeve me anë të rrjetit kompjuterik;
- 2.10. dërgim i kontrolluar të dërgesave postare
- 2.11. shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes;
- 2.12. blerje të simuluar të ndonjë sendi;
- 2.13. simulim të një veprë të korrupsionit; ose
- 2.14. zbulim i të dhënave financiare.

3. Kërkesa për marrjen e urdhrit për ndonjë nga masat e përcaktuara në paragrafët 1., 2. ose 3. të këtij neni bëhet me shkrim dhe përfshin të dhënat e mëposhtme:

3.1. identitetin e zyrtarit të autorizuar policor, zyrtarit të organit të autorizuar për të zbatuar ligjin penal ose prokurorit të shtetit që bën kërkesën;

3.2. arsyet dhe faktet që mbështesin kërkesën dhe përmbushin kushtet nga neni 88; dhe

3.3. të dhënat lidhur me çfarëdo kërkesë paraprake të njohur për paraqitësin e kërkesës që ka të bëjë me personin e njëjtë dhe veprimet e ndërmarra nga zyrtari i autorizuar gjyqësor lidhur me kërkesën e tillë.

[...]

Neni 92

Urdhrat për masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit

1. Urdhri për ndonjë masë të caktuar nga ky kapitull i cili nuk duhet ta kalojë periudhën prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e lëshimit të këtij urdhri i cili bëhet me shkrim dhe përmban:

1.1. emrin dhe adresën e personit ose të personave që i nënshtrohen urdhrin, nëse dihet numri i personave të prekur nga të dhënat dhe vendi i ngjarjes;

1.2. emërtimi zyrtar i masës dhe baza ligjore e saktë e saj;

1.3. në veçanti gjetjet e tanishme dhe gjasat reale sipas nenit 19 nënparagrafi 1. 11. të këtij Kodi;

1.4. masa dhe koha e saktë e fillimit dhe përfundimit të saj nëse zbatohet, dhe

1.5. personin e autorizuar për zbatimin e masës dhe zyrtarin përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të tillë.

2. Për urdhrin e lëshuar për ndonjë masë nga ky kapitulli, nga zyrtari i autorizuar i policisë kërkohet t'i paraqesë raport zyrtarit të autorizuar gjyqësor mbi zbatimin e urdhrin brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga dita e lëshimit të urdhrin.

3. Urdhri për vëzhgim të fshehtë fotografik ose me video në vende private, monitorim të bisedave në vende private, përgjim të telekomunikimeve, përgjim të komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik ose shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes mund ta autorizojë zyrtarin e autorizuar të policisë të hyjë në lokale private, nëse gjyqtari i procedurës paraprake vlerëson se hyrja e tillë është e domosdoshme për të aktivizuar ose pamundësuar mjetet teknike për zbatimin e masave të tilla. Kur zyrtarët e autorizuar të policisë hyjnë në lokale private në pajtim me urdhrin nga ky paragraf, veprimet e tyre në lokalet private duhet të kufizohen në veprimet e nevojshme për të aktivizuar apo çaktivizuar pajisjet teknike.

4. Urdhri për regjistrimin e bisedave telefonike ose përgjimin e komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik duhet të përfshijë të gjitha elementet për identifikimin e secilit telefon ose secilës pikë të qasjes në rrjetin kompjuterik që duhet të përgjohet. Përpos rasteve të parapara në paragrafin 5. të këtij neni, urdhri për përgjim të telekomunikimeve duhet të përmbajë të gjitha elementet për identifikimin e secilit telefon që duhet të përgjohet.

5. Me kërkesën e prokurorit të shtetit, urdhri për përgjimin e telekomunikimeve mund të përfshijë vetëm një përshkrim të përgjithshëm të telefonave që mund të përgjohen, kur gjyqtari i procedurës paraprake të gjykatës themelore kompetente çmon se ekziston dyshim i bazuar që:

5.1. i dyshuari shfrytëzon telefona të ndryshëm me qëllim të shmangies nga vëzhgimi i zyrtarit të autorizuar të policisë; dhe

- 5.2. një telefon apo telefonat e paraqitur në urdhër shfrytëzohen ose do të shfrytëzohen nga i dyshuari.
6. Kur urdhri për përgjimin e telekomunikimeve është lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake të gjykatës themelore, në pajtim me paragrafin 5. të këtij neni:
- 6.1. zyrtarët e autorizuar të policisë, pas zbatimit të urdhrit për një telefon të caktuar, menjëherë informojnë me shkrim gjyqtarin e procedurës paraprake mbi faktet e rëndësishme, duke përfshirë edhe numrin e telefonit;
- 6.2. urdhri nuk mund të shfrytëzohet për të përgjuar telekomunikimet e personit i cili nuk është i dyshuar; dhe
- 6.3. kohëzgjatja e urdhrit është e kufizuar deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë dhe mund të ripërtërihet deri në nëntëdhjetë (90) ditë nga dita e lëshimit të urdhrit.
7. Urdhri për kontroll të dërgesave postare ose dërgim të kontrolluar të dërgesave postare duhet të përfshijë adresën në dërgesat postare që duhet të kontrollohen ose dërgohen. Adresa e tillë duhet të përputhet me atë të personit ose të personave të përfshirë në urdhër.
8. Urdhri për përgjimin e telekomunikimeve, përgjimin e komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik, regjistrimin e thirrjeve telefonike, kontrollin e dërgesave postare, dërgimin e kontrolluar të dërgesave postare ose zbulimin e të dhënave financiare duhet të përfshijë si shtesë udhëzimin e veçantë me shkrim për personat, përveç zyrtarëve të autorizuar të policisë, ndihma e të cilëve mund të jetë e nevojshme për zbatimin e urdhrit. Udhëzimi i tillë me shkrim duhet t'i dërgohet drejtorit ose zyrtarit përgjegjës të sistemit të telekomunikimeve, rrjetit kompjuterik, shërbimit postar, bankës ose institucioneve të tjera financiare dhe duhet të përfshijë vetëm informacionin që kërkohet për ndihmë në zbatimin e urdhrit.

[...]

Neni 213

Qasja e të dyshuarit dhe të pandehurit në shkresat e lëndës

1. Gjatë hapave fillestarë të policisë, i dyshuari duhet të ketë qasje në dëshmitë që janë duke u mbledhur me kërkesë të tij, përveç rasteve ku paragrafi 6. ose 7. i këtij neni mund të aplikohet mutatis mutandis.
2. Me fillimin e hetimit, prokurori i shtetit është i detyruar që t'i sigurojë cilitdo të pandehur apo mbrojtësve të tyre qasje në shkresat e lëndës, përveç përjashtimeve të parapara me këtë nen.
3. Në asnjë fazë të hetimit mbrojtjes nuk mund t'i mohohet shikimi i shkresave lidhur me procesin e marrjes në pyetje të të pandehurit, shikimi i materialit të marrë nga i pandehuri apo materialit që i përket atij, shikimi i materialit lidhur me veprimet hetimore në të cilat është lejuar ose është dashur të lejohet pjesëmarrja e mbrojtësit ose shikimi i ekspertizave.
4. Pas përfundimit të hetimit, mbrojtja ka të drejtë të shikojë, të kopjojë ose t'i fotografojë të gjitha shkresat dhe provat materiale me të cilat disponon gjykata.
5. Pas ngritjes së aktakuzës, të pandehurit ose të pandehurve të cekur në aktakuzë mund t'u sigurohet kopja ose kopjet e shkresave të lëndëve.

6. Përveç të drejtave që i gëzon mbrojtja nga paragrafët 2., 3. dhe 4. të këtij neni, mbrojtjes i lejohet nga prokurori i shtetit që të shikojë, të kopjojë ose të fotografojë shkresa, libra, dokumente, fotografi dhe objekte të tjera materiale në posedim, ruajtje ose kontroll të prokurorit të shtetit, materiale të cilat shërbejnë për përgatitjen e mbrojtjes ose të cilat kanë për qëllim që të shfrytëzohen nga prokurori i shtetit si prova gjatë shqyrtimit gjyqësor, ose që janë marrë nga i pandehuri apo kanë qenë pronë e tij, varësisht nga rasti. Prokurori i shtetit mund t'i refuzojë mbrojtjes shikimin, kopjimin ose fotografimin e shkresave të caktuara, të librave, dokumenteve, fotografive dhe objekteve të tjera materiale në posedim, ruajtje ose nën kontroll të tij, nëse ka gjasa reale se shikimi, kopjimi ose fotografimi mund të rrezikojë qëllimin e hetimit, jetën ose shëndetin e njerëzve. Në rast të tillë, mbrojtja mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues që të lejojë shikimin, kopjimin ose fotokopjimin. Vendimi i gjyqtarit është përfundimtar.

7. Informacionet mund të redaktohet ose të shënjohe nga prokurori i shtetit me vijë të trashë të zezë për të fshehur të dhëna të caktuara në kopjet e shkresave të cilat përmbajnë të dhëna të ndjeshme. I pandehuri mund të kundërshtojë redaktimin te gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues brenda tre (3) ditëve nga pranimi i kopjes së redaktuar. Prokurorit të shtetit i jepet mundësia që të shpjegojë bazën ligjore të redaktimit pa zbuluar informacionin e ndjeshëm. Gjyqtari shqyrton informacionin e ndjeshëm dhe merr vendim brenda tre (3) ditëve nëse redaktimi është ligjërisht i arsyetuar.

8. Dispozitat e këtij neni varen nga masat për mbrojtjen e të dëmtuarve, dëshmitarëve dhe privatësisë së tyre si dhe për mbrojtjen e informacioneve konfidenciale, siç parashihet me ligj.

[...]

Neni 242

Procedura për ngritjen e aktakuzës

1. Aktakuza i paraqitet gjykatës kompetente në aq kopje sa ka të pandehur dhe mbrojtës të tyre dhe një kopje shtesë për gjykatën. Gjithashtu, gjykatës i dërgohet edhe lënda komplete e hetimit nga prokurori i shtetit.
2. [...]"

LIGJI Nr. 04/L-109 PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE

"Neni 68

Ruajtja dhe administrimi i të dhënave personale për qëllime të ndjekjes penale

1. Pavarësisht definicioneve tjera në këtë ligj, ndërmarrësit e rrjetave dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike janë të obliguar të ruajnë dhe të administrojnë për një periudhë jo më gjatë se një (1) vit skedaret e të dhënave për parapaguesit e vet duke u referuar në paragrafin 2. të këtij neni.

Kjo ruajtje duhet të paguhet nga fondet shtetërore në pajtueshmëri me procedurat e vendosura nga Qeveria.

2. Ndërmarrësit të cilët ofrojnë rrjeta të komunikimeve elektronike dhe/ose shërbime duhet të sigurojnë që ruhen kategoritë e të dhënave si në vijim:

2.1. të dhënat e nevojshme për të gjetur dhe identifikuar resursin e komunikimit në lidhje me rrjetin e telefonisë fikse dhe telefonisë mobile:

2.1.1. numri i telefonit thirrës;

2.1.2. emrin dhe adresën e parapaguesit ose përdoruesit të regjistruar;

2.2. të dhënat që kanë të bëjnë me qasjen nga Interneti, me email adresën e Internetit dhe me telefoninë përmes Internetit:

2.2.1. ID e ndarë e përdoruesit;

2.2.2. ID e përdoruesit dhe numrin e ndarë të telefonit të secilës hyrje komunikuese të rrjetit të telefonave publik;

2.2.3. emrin dhe adresën e parapaguesit, apo përdoruesit të regjistruar për të cilin është ndarë një adresë e Protokollit të Internetit (IP), një ID e përdoruesit apo numër i telefonit që i është ndarë atij në kohën e komunikimit;

2.3. të dhënat e domosdoshme për të identifikuar destinimin e komunikimit që kanë të bëjnë me rrjetën e telefonisë fikse dhe asaj mobile:

2.3.1. numrat e thirrur (numrat e telefonit të thirrur), dhe, në rastet e përfshirjes së shërbimeve plotësuese siç janë: bartja e thirrjes ose transferi i thirrjes, numri apo numrat tek të cilët është rutinuar thirrja;

2.3.2. emri(at) dhe adresa(t) e parapaguesit(ve) ose përdoruesit(ve).

2.4. të dhënat që kanë të bëjnë me e-mail adresën e Internetit dhe telefoninë përmes Internetit:

2.4.1. ID e përdoruesit ose numri i telefonit të marrësit të synuar të një thirrje të telefonisë përmes Internetit;

2.4.2. emri(at) dhe adresa(t) e parapaguesit(ve) ose përdoruesit(ve) të regjistruar dhe ID e përdoruesit të marrësit të synuar të komunikimit;

2.5. të dhënat e domosdoshme për të identifikuar datën, kohën dhe zgjatjen e komunikimit:

2.5.1. sa i përket telefonisë së rrjetit fiks dhe atij mobil, data dhe koha e fillimit dhe e mbarimit të komunikimit;

2.6. të dhënat që kanë të bëjnë me qasjen në Internet, e-mail adresa e Internetit, dhe telefoninë përmes Internetit:

2.6.1. data dhe koha e kyqjes dhe çkyqjes së shërbimit të qasjes së Internetit, duke u bazuar në zonën e saktë kohore, bashkë me IP adresën, qoftë dinamike apo statike, e ndarë nga Ofruesi i shërbimit të qasjes së Internetit, si dhe ID e përdoruesit të parapaguesit ose përdoruesit të regjistruar;

2.6.2. data dhe koha e kyqjes dhe çkyqjes në shërbimin e e-mailit ose shërbimin e telefonisë përmes Internetit, duke u bazuar në zonën e saktë kohore;

2.7. të dhënat e domosdoshme për të identifikuar llojin e komunikimit:

- 2.7.1. lidhur me telefoninë e rrjetit fiks dhe telefonisë mobile: shërbimi i përdorur i telefonit;
- 2.7.2. sa i përket e-mailit të Internetit dhe telefonisë përmes Internetit: Shërbimi i Internetit të përdorur;
- 2.8. të dhënat e domosdoshme për të identifikuar pajisjen komunikuese të përdoruesit ose për çfarë pretendon të jetë pajisja.
- 2.9. në lidhje me telefoninë e rrjetit fiks, numrat e telefonit të thirrësit dhe të të thirrurit;
- 2.10. në lidhje me telefoninë mobile;
- 2.11. numrat e telefonit të thirrësit dhe të të thirrurit;
- 2.12. numri identifikues internacional i shfrytëzuesit mobil (ang. IMSI) i palës thirrëse;
- 2.13. numri identifikues internacional i pajisjes mobile (ang. IMEI) i palës thirrëse;
- 2.14. numri IMSI i palës së thirrur;
- 2.15. numri IMEI i palës së thirrur;
- 2.16. në rastin e shërbimeve parapaguese anonime, data dhe koha kur është bërë aktivizimi i këtij shërbimi dhe emërtimi i lokacionit (ID e celulës) prej të cilës është bërë aktivizimi i shërbimit.
- 2.17. të dhënat që kanë të bëjnë me qasjen në Internet, e-mail adresa e Internetit, dhe telefoninë përmes Internetit:
- 2.18. numri i telefonit i thirrësit për lidhje dial-up;
- 2.19. linja digjitale e shfrytëzuesit (ang. DSL) ose ndonjë vend tjetër ku është iniciuar komunikimi;
- 2.20. të dhënat e domosdoshme për të identifikuar lokacionin e pajisjes komunikuese mobile:
- 2.20.1 emërtimi i lokacionit (ID e celulës) në fillim të komunikimit;
- 2.21. të dhënat që identifikojnë lokacionin gjeografik të celulare duke u referuar nga emri i lokacionit të tyre (ID e celulës) gjatë periudhës në të cilën të dhënat komunikuese kanë qenë në dispozicion.
3. Të dhënat e listuara në paragrafin 2. të këtij neni, duhet t'iu vihen në dispozicion edhe në formë elektronike dhe pas kërkesës së tyre autoriteteve përgjegjëse, siç përshkruhet në legjislacionin për Procedurë Penale në fuqi.”

Pranueshmëria e kërkesës

54. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
55. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë,

mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

56. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individidi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesjadëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtrueses i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”

57. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar; i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion; e ka qartësuar aktin e autoritetit publik kushtetutshmërinë e të cilit e konteston, konkretisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës PML.nr.137/2020, të 15 qershorit 2020; i ka specifikuar të drejtat kushtetuese të cilat pretendon se i janë cenuar; si dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit ligjor. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtrueses së kërkesës, i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe se e njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Gjykata gjithashtu thekson se kërkesa nuk është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, prandaj ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të shqyrtohen meritat e saj.

Meritat e kërkesës

58. Gjykata rikujton se Prokuroria Speciale kishte filluar hetime ndaj parashtrueses së kërkesës dhe disa personave të tjerë pasi ekzistonte dyshimi i bazuar se

parashtruesja e kërkesës ishte përfshirë në kryerjen e veprave penale nga paragrafi 2 i nenit 428 [Marrja e ryshfetit] dhe paragrafi 1 i nenit 431 [Ushtrimi i ndikimit] të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 04/L-082, pasi ajo mes viteve 2011 dhe 2013 në cilësi të personit zyrtar kishte marrë drejtpërdrejt për veten e saj dhe për kryes të tjerë të panjohur shumën prej 13.000.00 euro nga dëshmitari "C" në këmbim të lirim të këtij të fundit nga burg apo zbutjen e dënimit të tij për të cilin ai ishte dënuar. Ajo gjithashtu dyshohej se kishte marrë nga dy persona, 500.00 euro të tjera. Më 10 mars 2014, ishte autorizuar përgjimi i telekomandimeve dhe regjistrimi i thirrjeve telefonike duke përfshirë leximin retroaktiv të mesazheve tekstuale (SMS-ve) të parashtrueses së kërkesës dhe personave të tjerë të dyshuar. Më 31 maj 2016, Gjykata Themelore në Prizren kishte nxjerrë Urdhrin [PPS.8/2015] me të cilin dëshmitarit "C" i ishin caktuar masat mbrojtëse si dëshmitar i mbrojtur. Më 26 gusht 2016, Prokuroria Speciale kishte ngritur aktakuzë [PPSnr.8/2015] kundër parashtrueses së kërkesës për shkak të veprës penale nga paragrafi 2 i nenit 428 [Marrja e ryshfetit] dhe paragrafi 2 i nenit 431 [Ushtrimi i ndikimit] të KPRK-së si dhe ndaj personit B.V. për shkak të veprës penale nga paragrafi 3 i nenit 429 [Dhënia e ryshfetit], dhe paragrafi 2 i nenit 431 [Ushtrimi i ndikimit] të KPRK-së. Së bashku me aktakuzën parashtrueses së kërkesës i ishin dorëzuar 8 (tetë) CD me provat lidhur me rastin. Lidhur me çështjen e përgjimeve në mënyrë retroaktive parashtruesja e kërkesës po ashtu kishte paraqitur kërkesë për hedhjen e aktakuzës e cila ishte refuzuar nga Gjykata Themelore, vendim i cili ishte konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit.

59. Më 18 nëntor 2019, Gjykata Themelore shpalli fajtoresh parashtruesen e kërkesës për veprën penale nga neni 431 [Ushtrimi i ndikimit] i KPRK-së dhe i shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, dhe e liroi nga akuza për veprën penale nga paragrafi 2 i nenit 428 [Marrja e ryshfetit] të KPRK-së. Gjykata e Apelit, kishte refuzuar ankesat e palëve në procedurë. Ndërsa, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [PML.nr.29/2021] refuzoi kërkesën e parashtrueses së kërkesës dhe atë të B.V. për mbrojtje të ligjshmërisë, si të pabazuara. Gjykata Supreme gjeti se nuk qëndron fakti se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore është mbështetur në prova të papranueshme pasi i njëjti është mbështetur në transkriptet e takimit të zhvilluar në mes të parashtrueses së kërkesës dhe dëshmitarit "C", dëshminë e dëshmitarëve nga dëshmitë e të cilëve është vërtetuar se parashtruesja e kërkesës e ka kryer veprën penale për të cilën është dënuar. Sa i përket pamundësisë për të marrë në pyetje dëshmitarin "C", Gjykata Supreme theksoi se ky pretendim është i pabazuar pasi në ditën që dëshmitari "C" është dëgjuar më 9 qershor 2016, kanë qenë prezent edhe mbrojtësit e parashtrueses së kërkesës me ç'rast atyre u është bere me dije se dëshmitari "C" ka statusin e dëshmitarit të mbrojtur, por mbrojtësit e parashtrueses së kërkesës janë larguar nga seanca me arsyetimin se dëshmitarit nuk i dihet statusi, andaj, deklarata e dëshmitarit "C" vetëm është lexuar në seancën shqyrtuese dëgjimore dhe se e njëjta dëshmi nuk ka qenë vendimtare për të vërtetuar se parashtruesja e kërkesës e ka kryer veprën penale për të cilën është dënuar. Sa i përket pretendimit se SMS-ët janë nxjerrë në mënyrë retroaktive, Gjykata Supreme gjeti se ky fakt qëndron por sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme kjo nuk ka pasur ndikim në marrjen e vendimit ngase gjykata gjendjen e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë me te gjitha provat e tjera të administruara. Sa i përket pretendimit se parashtrueses së kërkesës nuk

i janë dhënë shkresat e lëndës gjatë fazës së hetimit, Gjykata Supreme theksoi se konform nenit 213, paragrafi 5 të KPPK-së, koha kur mbrojtja medeoemos duhet të pranojë shkresat e lëndës është koha kur është ngritur aktakuza dhe një gjë e tillë ka ndodhur në rastin konkret.

60. Parashtruesja e kërkesës pretendon para Gjykatës se në procedurën lidhur me akuzën penale kundër saj:
- (i) aktgjykimet e kontestuar bazohen në prova të cilat janë të papranueshme ligjërisht, konkretisht në SMS-te, që janë nxjerrë në mënyrë retroaktive. Këtë pretendim parashtruesja e kërkesës e ndërlidh me të drejtën për jetë private të garantuar me nenin 36 të Kushtetutës, nenin 8 të KEDNJ dhe 12 të DUDNJ si dhe me të drejtën për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, nenin 6 të KEDNJ dhe nenin 10 të DUDNJ;
 - (ii) nuk i ishte mundësuar qasje në dokumente të lëndës nga Prokuroria Speciale dhe gjyqtari i procedurës paraprake, gjatë fazës hetimore, e gjithë kjo në kundërshtim me parimin e barazisë së armëve dhe parimin e kontradiktoritetit të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, nenin 6 të KEDNJ dhe nenin 10 të DUDNJ;
 - (iii) nuk i është mundësuar marrja në pyetje e dëshmitarit “C”, nga parashtruesja e kërkesës apo mbrojtja e saj edhe pse një gjë e tillë është e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, nenin 6 të KEDNJ dhe nenin 10 të DUDNJ.
61. Në vazhdim Gjykata do të shqyrtoj fillimisht pretendimet që ndërlidhen me shkeljen e së drejtës për jetë private të garantuar me nenin 36 të Kushtetutës, nenin 8 të KEDNJ, pastaj do të vazhdoj me shqyrtimin e pretendimeve që ndërlidhen me të drejtën për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, nenin 6 të KEDNJ dhe nenin 10 të DUDNJ

I. LIDHUR ME TË DREJTËN PËR PRIVATËSI TË GARANTUAR ME NENIN 36 TË KUSHTETUTËS DHE NENIN 8 TË KEDNJ

62. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës para Gjykatës ngrit çështjen e SMS-vë të nxjerr në mënyrë retroaktive duke pretenduar se si rrjedhojë, aktgjykimet e kontestuar bazohen në prova të cilat janë të papranueshme ligjërisht, duke shkelur kështu të drejtat e saj kushtetuese.
63. Lidhur me këtë, përveç shkeljet e pretenduara të së drejtës për një gjykim të drejtë, të cilat pretendime do të vlerësohen nga Gjykata ndaras në këtë Aktgjykim, parashtruesja e kërkesës ngrit edhe çështjen e SMS-ve të nxjerrë në mënyrë retroaktive edhe në raport me të drejtën për privatësi të garantuar me Kushtetutë, KEDNJ dhe DUDNJ.

64. Lidhur me këtë, ajo thekson se sipas nenit 91 [Personat kompetent për të urdhëruar dhe zbatuar masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit] dhe 92 [Urdhrat për masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit] të KPPK-së, përgjimet e telekomunikimeve mund të bëhen vetëm prej datës së lëshimit të urdhrit për një periudhë të caktuar kohore dhe i cili urdhër mund të përtërihet por nuk mund të lëshohet në mënyrë retroaktive. Andaj, parashtruesja mban qëndrimin se Urdhri [PP 51/2014] i 10 marsit 2014, është në kundërshtim me të drejtën për privatësi sipas nenit 36, paragrafi 3 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së, pasi përmes këtij urdhri janë nxjerrë SMS në mënyrë retroaktive.
65. Lidhur me këtë ajo argumenton se e çdo person ka të drejtë që të i respektohet jeta e tij/saj private dhe familjare, vendbanimi dhe letërkëmbimi dhe se ndërhyrja në ushtrimin e kësaj të dejtë mund të bëhet vetëm në shkallën e parashikuar me ligj. Andaj, ajo, argumentet e saj i mbështet në dispozitat relevante të në KPPK-në konkretisht nenin 91 [Personat kompetent për të urdhëruar dhe zbatuar masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit] dhe nenin 92 [Urdhrat për masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit] të KPPK-së, por gjithashtu i referohet edhe nenit 68 [Ruajtja dhe administrimi i të dhënave personale për qëllime të ndjekjes penale] të Ligjit për Komunikimet Elektronike, duke pretenduar se përmbajtja e SMS-ve mund të ruhet vetëm për të ardhmen dhe atë prej ditës kur të lëshohet urdhri i gjykatës relevante.
66. Në vazhdim Gjykata do të elaborojë: (i) parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare; dhe (ii) aplikimi i tyre në rrethanat e rastit konkret. Gjykata do të bëjë këtë duke u bazuar në praktikën e saj gjyqësore por edhe të asaj të GJEDNJ-së, vendimet e së cilës janë të detyruara sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ku specifikisht përcaktohet që: *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*

Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare me theks të veçantë lidhur me përgjimin e bisedave telefonike

67. Gjykata fillimisht rikujton nenin 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës, që përcakton:

“1. Çdokush gëzon të drejtën që t’i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera.

[...]

3. Fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimit tjetër, është e drejtë e pacenueshme. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm përkohësisht, në bazë të vendimit gjyqësor, nëse është e domosdoshme për ecurinë e procedurës penale ose për mbrojtjen e vendit, në mënyrën e parashikuar me ligj.

[...]”

68. Gjykata gjithashtu rikujton nenin 8 të KEDNJ-së (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), që përcakton se:

“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”

69. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, i cili përcakton:

1. “Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.

2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.

3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.

4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.

5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrësi esencën e së drejtës së garantuar.”

70. Andaj, Gjykata rikujton se të drejtat e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë mund të kufizohen në raste të caktuara, nëse kufizimi ka qenë i paraparë me ligj, nëse kufizimi ndjek një qëllim legjitim dhe nëse kufizimi është i nevojshëm në një shoqëri demokratike.

71. Sa i përket të drejtës së privatësisë, Gjykata thekson se qëllimi parësor i nenit 8 të KEDNJ-së, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, është që të mbrojnë individët nga “ndërrhyrjet” arbitrare në jetën e tyre: (i) private; (ii) familjare; (iii) të vendbanimit; ose (iv) të korrespondencës (shih rastin e Gjykatës KI56/18, parashtrues: *Ahmet Frangu*, Aktgjykim i 22 korrikut 2020, paragrafi 83; shih, në këtë kontekst, ndër tjerash, edhe rastet e GJEDNJ-së, *P. dhe S. kundër Polonisë*, Aktgjykim i 30 tetorit 2012, paragrafi 94; dhe *Nunez kundër*

Norvegjisë, Aktgjykim i 28 qershorit 2011, paragrafi 68). Disa çështje, padyshim që mund të prekin më shumë se një nga interesat e mbrojtura me nenet e lartcekura. Këto të drejta, bazuar në sistemin e KEDNJ-së dhe praktikën relevante gjyqësore të GJEDNJ-së, sigurohen përmes: (i) detyrimeve negative, përkatësisht detyrimit të shtetit për të mos “ndërhyrë” në jetën private dhe familjare; dhe (ii) detyrimeve pozitive, përkatësisht detyrimit të shtetit për t’u siguruar që këto të drejta të gëzohen në mënyrë efektive (shih rastin e Gjykatës KI56/18, parashtues: *Ahmet Frangu*, Aktgjykim i 22 korrikut 2020, paragrafi 83).

72. Në këtë aspekt, GJEDNJ ka theksuar se bisedat telefonike janë të mbuluara me nocionin e “jetës private” dhe “korrespondencës” brenda kuptimit të nenit 8 të KEDNJ. Monitorimi i tyre përbën ndërhyrje në ushtrimin e të drejtës së secilit, të mbrojtur me nenit 8 të KEDNJ-së (shih rastet e GJEDNJ-së *Malone kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 2 gushtit 1984, paragrafi 64; dhe rastin *Dragojević kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 15 prillit 2015, paragrafi 78).
73. Një ndërhyrje e tillë arsyetohet me termin e përdorur me paragrafin 2 të nenit 8 të KEDNJ-së vetëm nëse është “në pajtim me ligjin”, nëse ndjek një “qëllim legjitim” të paraparë në paragrafin 2 të nenit 8 të KEDNJ dhe nëse është e “nevojshme në një shoqëri demokratike” (shih rastet e GJEDNJ-së *Kvasnica kundër Sllovakisë*, Aktgjykim i 9 qershorit 2009, si dhe rastin *Dragojević kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 79).
74. Shprehja, “në pajtim me ligjin”, sipas paragrafit 2 të nenit 8 të KEDNJ-së në përgjithësi kërkon që, së pari masa e ndërmarrë duhet të ketë bazë në të drejtën e brendshme; dhe gjithashtu i referohet kualitetit të ligjit në fjalë që duhet të jetë në pajtueshmëri me sundimin e ligjit dhe i qasshëm për personin ndaj të cilit zbatohet, i cili duhet, për më tepër, të jetë në gjendje të parasheh pasojat për të, në pajtueshmëri me sundimin e ligjit (shih rastin e GJEDNJ-së, *Kruslin kundër Francës*, Aktgjykimi i 24 prillit 1990, paragrafi 27, dhe rastin *Dragojević kundër Kroacisë*, cituar më lartë, paragrafi 81).
75. Në veçanti, në kontekst të masave të fshehta të vëzhgimit si përgjimi i komunikimeve, kërkesa për “parashikueshmëri” ligjore nuk mund të nënkuptojë se individit duhet të jetë në gjendje të parasheh kur autoritetet shtetërore mund të përgjojnë komunikimet në mënyrë që ai/ajo të mund të përshtatë sjelljen e tij/saj në këtë aspekt. Megjithatë, kur jepet një urdhër ekzekutiv dhe ushtrohet në mënyrë sekrete, rreziku i arbitraritetit është evident. Për këtë arsye, e drejta e brendshme duhet të jetë mjaftueshëm e qartë në mënyrë që individit t’i jepet një indikacion sa i përket rrethanave në të cilat dhe kushtet në bazë të të cilave autoritetet publike kanë mundësi të ndërmarrin masat e tilla (shih rastet e GJEDNJ-së *Huwig kundër Francës*, Aktgjykim i 24 prillit 1990, paragrafi 29, *Valanzuela Contreras kundër Spanjës*, Aktgjykim i 30 korrikut 1998, paragrafi 29, si dhe rastin *Dragojević kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 81.)
76. GJEDNJ gjithashtu ka sqaruar nevojën për masa mbrojtëse në këtë aspekt. Në veçanti, pasi zbatimi në praktikë i masave të vëzhgimit sekret të komunikimeve

nuk është i hapur për kontroll nga individët e prekur apo nga publiku i gjerë, do të ishte në kundërshtim me sundimin e ligjit për diskrecionin juridik të dhënë ekzekutivit apo gjyqtarit që të shprehet në kompetencë të pakufizuar. Si pasojë, ligji duhet të përcaktojë fushëveprimin e një diskrecioni të tillë që i jepet autoritetit kompetentë dhe mënyra si ushtrohet, të ketë qartësi të duhur që t'i jepet individit mbrojtje e duhur nga ndërhyrja arbitrare (shih rastet e GJEDNJ *Bykov kundër Ruisë*, Aktgjykim i 10 prill 2009, paragrafi 78; dhe rastin *Dragojević kundër Koracisë*, cituar më lart, paragrafi 83).

77. Për më tepër, duke pasur parasysh rrezikun që sistemi i vëzhgimit sekret për sigurinë nacionale, mund të minojë apo shkatërrojë demokracinë me pretekst të ruajtjes së saj, GJEDNJ duhet të jetë e bindur që ekziston garanci ndaj abuzimeve që janë adekuate dhe efektive. Ky vlerësim varet nga të gjitha rrethanat e rastit, si natyra, fushëveprimi dhe kohëzgjatja e masave të mundshme, bazën që kërkohet për të urdhëruar ato, autoritetin kompetent që lejon, që ekzekuton dhe që mbikëqyr një gjë të tillë, dhe mundësitë e korrektimit që parashihen nga e drejta e brendshme (shih rastet e GJEDNJ *Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i 6 qershorit 1978, dhe rastin *Dragojević kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 83).
78. Kjo në veçanti merr rëndësi në pyetjen nëse ndërhyrja është e nevojshme “në një shoqëri demokratike” për të arritur një qëllim legjitim, pasi GJEDNJ ka përcaktuar se autorizimi për të lejuar mbikëqyrje sekrete të qytetarëve tolerohet sipas nenit 8 të KEDNJ, vetëm në masën që është domosdoshmërisht e nevojshme për të mbrojtur institucionet demokratike. Në vlerësimin e ekzistimit dhe gjerësinë e kësaj nevoje, shtetet anëtarë kanë një hapësirë vlerësimi por kjo hapësirë vlerësimi është subjekt i mbikëqyrjes Evropiane. GJEDNJ duhet të vendos nëse procedurat e mbikëqyrjes së dhënies së urdhrave dhe zbatimin e masave kufizuese janë të tilla që mbajnë “ndërhyrjen” si të “nevojshme në shoqëri demokratike”. Për më tepër, vlerat e shoqërisë demokratike duhet të respektohen me mirëbesim në mënyrë që kufijtë e “nevojës” brenda paragrafit 2 të nenit 8 të KEDNJ-së të mos tejkalohen (shih rastet e GJEDNJ-së *Kvasnica kundër Sllovakisë*, cituar më lart, paragrafi 80; dhe *Dragojević kundër Kroacisë*, paragrafi 84).
79. Mbi bazën e parimeve të përgjithshme të elboruara më lart, Gjykata në vazhdim do të vlerësojë: (i) nëse përgjimi i telefonave dhe SMS-vë të parashtrueses së kërkesës konsiderohet ndërhyrje në të drejtën e saj për “jetë private” dhe “korrespondencë” të garantuar me nenin 36 të Kushtetutës, nenin 8 të KEDNJ dhe nenin 12 të DUDNJ-së. Nëse përgjigja në këtë pyetje është pozitive Gjykata do të vlerësojë: (ii) nëse një ndërhyrje e tillë është “e përcaktuar me ligj”; (iii) nëse ndërhyrja ka “qëllim legjitim” dhe është (iv) “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

Aplikimi i këtyre parimeve në rastin konkret

- (i) *Nëse ka pasur një ndërhyrje*

80. Ashtu si u sqarua më lart tek parimet e përgjithshme, dhe bazuar në ato parime, nuk është kontestuese që përgjimi i telefonave dhe SMS-vë të parashtrueses së kërkesës konsiderohet ndërhyrje në të drejtën e saj për “jetë private” dhe “korrespondencë” të garantuar me nenin 36 të Kushtetutës, nenin 8 të KEDNJ dhe nenin 12 të DUDNJ-së. Andaj, në vazhdim Gjykata do të trajtojë nëse ndërhyrja ka qenë e përcaktuar me ligj.

(ii) Nëse kufizimi ka qenë i paraparë me ligj

81. Gjykata fillimisht thekson se parashtruesja e kërkesës në rastin konkret nuk e konteston çështjen e përgjimit ndaj saj në përgjithësi dhe bazën ligjore për përgjim të telefonatave dhe mesazheve SMS. Ajo specifikisht e konteston autorizimin dhe nxjerrjen e leximin e SMS-vë në mënyrë retroaktive duke u bazuar në Urdhrin [PP.51/2014], të 10 marsit 2014, të Gjykatës Themelore në Prizren, që sipas saj ka rezultuar në nxjerrjen e të gjithë SMS-ve të saj prej datës 22 shkurt 2012 deri me 10 mars 2013, megjithëse Urdhri ishte nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prizren, me 10 mars 2014.
82. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht duhet të vlerësojë legjislacionin që ndërlidhet me çështjen e përgjimeve, por duke pasur parasysh që kemi të bëjmë me një rast individual që është trajtuar nga gjykatat e rregullta, Gjykata do të fokusohet jo vetëm në ligjin si të tillë por edhe në mënyrën se si është zbatuar ligji në rastin konkret.
83. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se Urdhri për përgjim [PP.51/2014], i 10 marsit 2014, ishte nxjerrë duke u bazuar në dispozitat relevante të KPPK-së, ndaj parashtrueses së kërkesës dhe disa personave të tjerë “*Për masa të fshehta për përgjimin e telekomunikimeve dhe regjistrimin e thirrjeve telefonike duke përfshirë leximin retroaktiv të mesazheve tekstuale (SMS-ve)*” duke autorizuar veprimet e më poshtme:

“1.Pergjimin e telekomunikimeve: në mënyrë specifike për të përgjuar, monitoruar, regjistruar transkriptuar të gjitha thirrjet telefonike, mesazhet me zë dhe mesazhet me tekst të bëra në ose nga numrat e telefonit të përmendura më poshtë pa dijeninë ose pëlqimin e personit që i nënshtrohet kësaj mase dhe për nxjerrjen e regjistrimeve të thirrjeve për numrat telefonik DHE

Regjistrimin: për përfshirje në mënyrë retroaktive të të gjitha thirrjeve hyrëse dhe dalëse dhe mesazheve tekstuale të bëra (SMS-eve), të dërguara dhe të pranuar nga te dyshuarit dhe personat tjerë, pos të dyshuarve nga 1 shtatori 2013 deri me tani për numrat e telefonit të përmendura më poshtë.”

84. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet bazës ligjore, së cilës i ishte referuar Urdhri i lartcekur, konkretisht nenit 91 [Personat kompetent për të urdhëruar dhe zbatuar masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit] të KPPK-së që në paragrafin 2, nënparagrafët 2.4 dhe 2.8 përcakton se gjyqtari i procedurës parapake mund të urdhërojë: regjistrim të bisedave telefonike si dhe përgjim të

telekomunikimeve, përfshirë tekstet e mesazheve ose mesazhet e tjera elektronike. Ndërsa neni 92 [Urdhrat për masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit] i KPPK-së përcakton se: “1. Urdhri për ndonjë masë të caktuar nga ky kapitull i cili nuk duhet ta kalojë periudhën prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e lëshimit të këtij urdhri i cili bëhet me shkrim dhe përmban:[...]”.

85. Gjykata po ashtu rikujton se neni 68 [Ruajtja dhe administrimi i të dhënave personale për qëllime të ndjekjes penale] i Ligjit për Komunikime Elektronike përcakton në paragrafin 1 se: “Ndërmarrësit e rrjetave dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike janë të obliguar të ruajnë dhe të administrojnë për një periudhë jo më gjatë se një (1) vit skedaret e të dhënave për parapaguesit e vet duke u referuar në paragrafin 2. të këtij neni”. Ndërsa në paragrafin 2 ky nen i Ligjit përcakton se “Ndërmarrësit të cilët ofrojnë rrjeta të komunikimeve elektronike dhe/ose shërbime duhet të sigurojnë që ruhen kategoritë e të dhënave”, duke përfshirë: të dhënat e nevojshme për të gjetur dhe identifikuar resursin e komunikimit në lidhje me rrjetin e telefonisë fikse dhe telefonisë mobile, të dhënat e domosdoshme për të identifikuar destinimin e komunikimit që ka të bëjë me rrjetën e telefonisë fikse dhe asaj mobile, të dhënat që kanë të bëjnë me e-mail adresën e internetit dhe telefoninë përmes Internetit; të dhënat e domosdoshme për të identifikuar datën, kohën dhe zgjatjen e komunikimit; të dhënat që kanë të bëjnë me qasjen në Internet, e-mail adresa e Internetit, dhe telefoninë përmes Internetit; të dhënat e domosdoshme për të identifikuar llojin e komunikimit; të dhënat e domosdoshme për të identifikuar pajisjen komunikuese të përdoruesit ose për çfarë pretendon të jetë pajisja; në lidhje me telefoninë e rrjetit fiks, numrat e telefonit të thirrësit dhe të thirrurit. Paragrafi 3 i këtij neni përcakton se: “Të dhënat e listuara në paragrafin 2. të këtij neni, duhet t’u vihen në dispozicion edhe në formë elektronike dhe pas kërkesës së tyre autoriteteve përgjegjëse, siç përshkruhet në legjislacionin për Procedurë Penale në fuqi”.
86. Bazuar në të lartcekurat, Gjykata ka parasysh se dispozitat e KPPK-së që rregullojnë çështjen e përgjimit përcaktojnë se përgjimet telefonike, duke përfshirë mesazhet telefonike, duhet të bëhen vetëm sipas urdhrit të gjyqtarit të procedurës parapake dhe mund të urdhërohet për 60 ditë nga dita e nxjerrjes së urdhrit. Në këtë aspekt, sipas dispozitave të lartcekura të KPPK-së rezulton se përgjimi retroaktiv duke përfshirë edhe përmbajtja e SMS-ve në mënyrë retroaktive, nuk është i lejuar. Kjo për faktin se KPPK përcakton në mënyrë shprehimore se urdhri për përgjim nuk duhet ta kalojë periudhën prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga “data e lëshimit”, duke mos krijuar mundësi që një gjë e tillë të bëhet në mënyrë retroaktive. Gjithashtu, sipas Ligjit për Komunikime Elektronike, ruajtja e bisedave telefonike apo përmbajtjes së SMS-ve as nuk është obligim ligjor i ndërmarrjeve që ofrojnë shërbime të tilla. Kjo pasi Ligji i Komunikimeve Elektronike detyron këto ndërmarrje që të ruajnë për një vit të dhëna specifike për qëllime penale, por që kanë të bëjnë kryesisht me numrat e thirrur nga qytetarët, pajisjen nga të cilat janë thirrur por jo edhe përmbajtjen e thirrjeve dhe mesazheve telefonike.

87. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se pretendimet e parashtrueses së kërkesës se në mënyrë të paligjshme i janë nxjerrë SMS në mënyrë retroaktive, kanë qenë subjekt i shqyrtimit nga gjykatat e rregullta në dy procedura gjyqësore.
88. Fillimisht, këto pretendime ishin ngritur nga parashtruesja e kërkesës para Gjykatës Themelore përmes kërkesës për hedhje të aktakuzës, ku kjo e fundit përmes Aktvendimit [PKR.nr.484/2016] të 23 dhjetorit 2016, kishte refuzuar kërkesat për hedhjen e aktakuzës. Lidhur me marrjen e SMS-vë në mënyrë retroaktive, Gjykata Themelore kishte arsyetuar se dispozitat e KPPK-së që rregullojnë çështjen e përgjimeve, konkretisht neni 92 i KPPK-së që përcakton periudhën 60 ditore nga *“data e lëshimit”* të urdhrin, nuk e ndalojnë në mënyrë shprehimore marrjen e SMS-vë në mënyrë retroaktive. Vet Gjykata Themelore në fakt kishte konstatuar se neni 92 i KPPK-së *“nuk përcakton ndonjë nocion retroaktiv ashtu si pretendon mbrojtja, pra fare nuk përmend nocionin retroaktiv dhe nuk ndalon marrjen e të dhënave të komunikimeve për periudhë të komunikimit të cilat kanë ndodhur para datës së lëshimit të urdhrin”*.
89. Gjykata Themelore arsyeton po ashtu se një konkluzion i tillë mbështet edhe në nenin 68 [Ruajtja dhe administrimi i të dhënave personale për qëllime të ndjekjes penale] të Ligjit Nr.04/L-109 për Komunikimet Elektronike që përcakton kohën sa duhet të ruhen këto komunikime apo skedarë nga operatorët e telefonisë apo rrjeteve të telekomunikimit. Për më tepër, Gjykata Themelore në këtë rast, përkundër faktit që një kufizim i tillë i marrjes së SMS-ve në mënyrë retroaktive nuk ishte i përcaktuar specifikisht me KPPK, mjaftohet me faktin që *“këto të dhëna janë siguruar me kërkesën e PSRK-së nga Gjyqtari i Procedurës Paraprake dhe atë me urdhërese të hartuar në harmoni me ligjin dhe atë brenda afatit ligjor”*. Ndërsa Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PN.nr.22/17] të 16 janarit 2017, kishte refuzuar ankesën e parashtrueses së kërkesës ndaj Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, të 23 dhjetorit 2016, duke konfirmuar arsyetimin e Gjykatës Themelore lidhur me SMS-ët retroaktivë dhe duke miratuar arsyetimin e Gjykatës Themelore.
90. Parashtruesja e kërkesës e kishte ngritur të njëjtin pretendim edhe gjatë shqyrtimit kryesor duke kontestuar nxjerrjen e SMS-vë në mënyrë retroaktive e cila ishte urdhëruar, sipas saj, në kundërshtim me ligjin dhe të drejtën e saj për jetë private dhe korrespondencë. Në këtë aspekt, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR.nr.623/2019], të 30 shtatorit 2020, e refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës lidhur me këtë pretendim duke arsyetuar se *“nuk janë të bazuara pretendimet e mbrojtësve të akuzuarve se aktgjykimi bazohet në prova të papranueshme dhe se urdhri i Gjykatës [për përgjim] përmban periudhën 22.02.2012 deri me 10.03.2013”*.
91. Ndërsa këtij pretendimi të parashtrueses së kërkesës, Gjykata Supreme, duke vepruar sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, i ishte përgjigjur duke theksuar se *“Pretendimet e mbrojtjes se SMS-të janë nxjerrë në mënyrë retroaktive prej datës 22.02.2012 deri më datën 10.03.2013, ky fakt qëndron, por sipas vlerësimit të kësaj gjykate SMS-të e nxjerra në këtë kohë, në të cilat po pretendon mbrojtja, nuk kanë pasur ndonjë ndikim në ligjshmërinë e marrjes së vendimit ngase gjykata gjendjen faktike e ka vërtetuar në mënyrë”*

të plotë dhe të drejtë më të gjitha provat tjera të administruara, të theksuara edhe më lartë gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi [...] dhe nuk bazohet në SMS-të retroaktive”.

92. Në këtë aspekt, pavarësisht interpretimeve të Gjykatave të rregullta, Gjykata vëren se sipas dispozitave relevante të KPPK-së rezulton se nuk është i lejuar që të urdhërohen përgjimet telefonike në mënyrë retroaktive, duke përfshirë marrjen e SMS-ve në mënyrë retroaktive. Kjo duke pasur parasysh se KPPK përcakton në mënyrë shprehimore se një urdhër i tillë nuk duhet ta kalojë periudhën prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga “*data e lëshimit*”, Gjithashtu, as operatorët e rrjeteve nuk kanë obligim që të ruajnë këto të dhëna konform ligjit për Komunikimet Elektronike.
93. Për më tepër, Gjykata vëren një interpretim kundërthënës lidhur me këtë nga gjykatat e rregullta. Në këtë aspekt, në njërën anë, Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit kishin vlerësuar se duke pasur parasysh që KPPK nuk e ndalon në mënyrë shprehimore leximin retroaktiv të mesazheve SMS, atëherë mund të urdhërohet edhe marrja e SMS-ve në mënyrë retroaktive. Ndërsa në anën tjetër, Gjykata Supreme duke shqyrtuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë ndaj vendimeve të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit, kishte vlerësuar se: (i) SMS-ët ishin nxjerrë në mënyrë retroaktive përmes Urdhrit [PP:51/2014] të 10 marsit 2014; por megjithatë kishte vlerësuar se këta SMS (ii) nuk kanë pasur ndikim në ligjshmërinë e marrjes së vendimit për dënim pasi gjendja faktike ishte vërtetuar me prova të tjera që ishin të pranueshme.
94. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton edhe njëherë se sipas parimeve të përgjithshme të përcaktuara më lart, një ligj që rregullon çështjen e përgjimeve duhet të jetë i parashikueshëm në mënyrë që të plotësojë kriteret e nenit 8 të KEDNJ-së. GJEDNJ ka përcaktuar se në kontekst të masave të fshehta të vëzhgimit si përgjimi i komunikimeve, kërkesa për “*parashikueshmëri*” ligjore nuk mund të nënkuptojë se individit duhet të jetë në gjendje të parashih kur autoritetet mund të përgjojnë komunikimet në mënyrë që ai/ajo të mund të përshtatë sjelljen e tij/saj në këtë aspekt. GJEDNJ thekson se kur jepet një urdhër ekzekutiv dhe ushtrohet në mënyrë sekrete, rreziku i arbitraritetit është evident. Për këtë arsye, e drejta e brendshme duhet të jetë mjaftueshëm e qartë në mënyrë që individit t’i jepet një indikacion sa i përket rrethanave në të cilat dhe kushtet në bazë të të cilave autoritetet publike kanë mundësi të ndërmarrin masat e tilla.
95. Andaj, duke pasur parasysh parimet e përgjithshme të përcaktuara nga GJEDNJ, dispozitat relevante të KPPK-së dhe Ligjit për Komunikimet Elektronike rezulton se përgjimi retroaktiv, duke përfshirë nxjerrjen dhe leximin i mesazheve (SMS-ve) në mënyrë retroaktive, është i e ndaluar. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se nxjerrja e përmbajtjes së SMS-ve në mënyrë retroaktive, në rastin konkret nuk është një masë e “paraparë me ligj”, ashtu si kërkohet me parimet e të drejtës për privatësi të garantuar me nenin 36 të Kushtetutës, dhe nenin 8 të KEDNJ-së. Kjo për më tepër duke pasur parasysh faktin që neni 92 i KPPK-së përcakton në mënyrë shprehimore që urdhri për përgjim nuk duhet ta kalojë periudhën prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga “*data e lëshimit*”,

96. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se për rrethanat e rastit konkret relevante është “pyetja e parë” e testit të nenit 55 të Kushtetutës, respektivisht se “*a ka qenë kufizimi i një lirie apo të drejtë themelore të garantuar me Kushtetutë “i përcaktuar me ligj?”*”. Pasi Gjykata sapo konstatoi se kufizimi i të drejtës për privatësi të garantuar me nenin 36 të Kushtetutës, dhe nenin 8 të KEDNJ-së, nuk ka qenë i paraparë me ligj, atëherë nuk është e nevojshme përgjigja në pyetjet nëse ky kufizim ka pasur qëllim legjitim, dhe nëse ka qenë i nevojshëm në një shoqëri demokratike (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës KO157/18, parashtrues *Gjykata Supreme*, Aktgjykim i 13 marsit 2019, paragrafi 114).
97. Nga si u tha më lart, Gjykata konsideron se leximi retroaktiv i mesazheve SMS përmes Urdhrit [PP: 51/2014] të Gjykatës Themelore në Prizren, të 10 marsit 2014, ka shkelur të drejtën e parashtrueses së kërkesës të garantuar me nenin 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës, dhe nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të KEDNJ-së..
98. Gjykata rikujton se konkluzioni i lartcekur për shkelje të së drejtës për privatësi nuk nënkupton domosdoshmërisht se në rastin e parashtrueses së kërkesës ka pasur po ashtu shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë si rezultat i leximit retroaktiv të mesazheve SMS. Një konstatim i tillë do të mund të arrihet vetëm pasi të bëhet vlerësim i detajuar i pretendimeve të parashtrueses në raport me garancitë procedurale të parapara në kuadër të së drejtë për një gjykim të drejtë me ç ‘rast, ashtu si do të sqarohet më poshtë, thelbësore është që të vlerësohet nëse lidhur me çështjen e provave, duke përfshirë SMS-ët e nxjerrë në mënyrë retroaktive, (i) parashtruesi ka pasur mundësi ti sfidoj gjatë procedurës penale, nëse po, (ii) nëse të njëjtat kanë pasur ndikim thelbësor në përcaktimin e akuzës penale ndaj parashtrueses së kërkesës.
99. Në këtë linjë argumentimi, Gjykata rikujton se, GJEDNJ në disa raste të paraqitura para saj, ka gjetur se përdorimi i mjeteve të fshehta të vëzhgimit ka shkelur të drejtën për privatësi të garantuar me nenin 8 të KEDNJ-së, pasi i njëjti nuk ka qenë “*i paraparë me ligj*”. Megjithatë, GJEDNJ, duke vlerësuar shkeljet e pretenduara në raport të drejtën për një gjykim të drejtë, ka gjetur se provat e marra përmes kësaj mase në rrethanat e rasteve specifike nuk kanë shkelur kriteret e një gjykimi të drejtë të garantuar me paragrafin 1. të nenin 6. të KEDNJ-së (shih rastet e GJEDNJ-së *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 12 majit 2000, paragrafët 29 deri 40; *Bykov kundër Rusisë*, Aktgjykim 10 marsit 2009, paragrafët 84-105; *Dragojević kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 130, dhe *Dragos Ioan Rusu kundër Rumanisë*, paragrafët 84-105).
100. Andaj, në vazhdim Gjykata do të trajtoj pretendimet e parashtrueses së kërkesës në raport me të drejtën për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

II. LIDHUR ME TË DREJTËN PËR NJË GJYKIM TË DREJTË TË GARANTUAR ME NENIN³¹ TË KUSHTETUTËS DHE NENIN 6 TË KEDNJ

i) *Lidhur me qasjen në dokumente të lëndës nga Prokuroria Speciale dhe gjyqtari i procedurës paraprake, gjatë fazës hetimore*

101. Lidhur me të drejtën për një gjykim të drejtë parashtruesja e kërkesës fillimisht pretendon se duke mos i mundur qasje në dokumente të lëndës nga Prokuroria Speciale dhe gjyqtari i procedurës paraprake, gjatë fazës hetimore, i është shkëlur parimi i barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit si pjesë përbërëse e një gjykimi të drejtë.

Parimet e përgjithshme në bazë të praktikës gjyqësore të Gjykatës, si dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së lidhur me parimin e barazisë së armëve dhe parimin e kontradiktoritetit

102. Gjykata, duke iu referuar edhe praktikës gjyqësore të saj dhe praktikën gjyqësore GJEDNJ-së, fillimisht thekson se parimi i “barazisë së armëve” është element i një koncepti më të gjerë të një gjykimi të drejtë (shih rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues: *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 97).
103. GJEDNJ-ja dhe Gjykata, në praktikën e tyre gjyqësore, kanë theksuar se parimi i “barazisë së armëve”, kërkon një “ekuilibër të drejtë midis palëve”, ku secilës palë i duhet dhënë mundësia e arsyeshme të paraqes rastin e tij/saj nën kushte që nuk do të vendosin atë në disavantazh të konsiderueshëm *vis-à-vis* palës kundërshtarë (shih rastin e Gjykatës KI230/19, cituar më lart, paragrafi 98; shih gjithashtu rastet e GJEDNJ-së *Yvon kundër Francës*, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 31 dhe *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës*, Aktgjykim i 27 tetorit 1993, paragrafi 33, shih rastet e Gjykatës, KI52/12, parashtrues *Adije Iliri*, Aktgjykim i 5 korrikut 2013, KI103/10, parashtrues *Shaban Mustafa*, Aktgjykim i 20 marsit 2012, paragrafi 40).
104. Gjykata më tej rikujton se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka përcaktuar se kërkesa e barazisë së armëve, në kuptim të një ekuilibri të drejtë midis palëve, vlen në parim si për rastet civile ashtu edhe për ato penale (shih rastin e Gjykatës KI230/19, cituar më lart, paragrafi 99; shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-s *Dombo Behër B.V. kundër Holandës*, Aktgjykim i 27 tetorit 1993, paragrafi 33).
105. Për më tepër, Gjykata gjithashtu thekson se gjykimi i drejtë përfshin edhe të drejtën e gjykimit në pajtim me “parimin e kontradiktoritetit”, parim i cili është i ndërlidhur me parimin e “barazisë së armëve”. (shih rastin e Gjykatës KI230/19, cituar më lart, paragrafi 99).
106. Për më tepër, në kuadër të procedurës penale, GJEDNJ ka nënvizuar se “[ë]shtë një aspekt themelor i së drejtës për një gjykim të drejtë që procedurat penale, përfshirë edhe elementet e procedurave të tilla që kanë të bëjnë me vetë

procedurën, duhet të jenë në pajtim me parimin e kontradiktoritetit dhe se duhet të ekzistojë barazia e armëve ndërmjet prokurorisë dhe mbrojtjes” (shih rastin e GJEDNJ-së *Leas kundër Estonisë*, kërkesa nr. 59577/08, Aktgjykim i 6 marsit 2012, paragrafi 77). Rrjedhimisht, përkitazi me parimin e kontradiktoritetit, GJEDNJ theksoi se, në një procedurë penale, si prokuroria ashtu edhe mbrojtja duhet të kenë mundësinë që të kenë njohuri dhe të bëjnë komente për të gjitha vërejtjet dhe për të gjitha provat e paraqitura nga pala tjetër (shih rastin *Brandstetter kundër Austrisë*, të cituar më lartë, paragrafi 67).

107. Më specifikisht, neni 6. paragrafi 3. (b) i KEDNJ-së, i garanton të akuzuarve “kohë dhe vend adekuat për përgatitjen e mbrojtës së tij” që nënkupton se aktiviteti i mbrojtjes substanciale në emër të tij/saj përfshin gjithçka që është e “nevojshme” të përgatitet për shqyrtimin kryesor. I akuzuari duhet të ketë mundësinë të organizojë mbrojtjen e tij në mënyrë të duhur dhe pa kufizime sa i përket mundësisë për të paraqitur argumentet relevante për mbrojtje në shqyrtim gjyqësor dhe kështu të ndikojë në rezultatin e procedurës (shih rastet e GJEDNJ-së *Leas kundër Estonisë*, Aktgjykim i 6 qershorit 2012, paragrafi 79 dhe *Moiseyev kundër Rusisë*, Aktgjykim i 6 prillit 2009, paragrafi 220).
108. Andaj, Gjykata në trajtimin e pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, do ti përmbahet këtyre parimeve.

Aplikimi i këtyre parimeve në rastin e parashtrueses së kërkesës

109. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendimin e saj për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit në mënyrë specifike e ndërlidhë me faktin që nuk i ishte mundësuar qasje në dokumente të lëndës nga Prokuroria Speciale dhe gjyqtari i procedurës paraprake, gjatë fazës hetimore. Megjithëse, provat lidhur me rastin ndaj parashtrueses së kërkesës ishin dorëzuar së bashku me aktakuzën e dorëzuar në Gjykatë dhe të cilat i kishte pranuar edhe parashtruesja e kërkesës.
110. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata rikujton se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme kishte arsyetuar se: “Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, sipas nenit 213 par.3 te KPPK mbrojtjes në asnjë fazë të hetimit nuk mund ti mohohet shikimi i shkresave të lëndës, mirëpo kjo ka të bëjë me shikimin e shkresave të lëndës ndërsa sipas nenit 213 par. 5 te KPPK, koha kur mbrojtja medoemos duhet të furnizohet edhe fizikisht me shkresa të lëndës është koha pas ngritjes së aktakuzës, gjë që një gjë e tillë është bërë”.
111. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës më rastin e ngritjes së aktakuzës kishte pranuar të gjitha provat që ndërlidheshim me akuzën e saj penale nga Prokuroria.
112. Rrjedhimisht, Gjykata thekson se parashtruesja e kërkesës, pas pranimit të aktakuzës dhe materialeve të tjera hetimore, ka pasur mundësi dhe kohë të mjaftueshme që para gjykatave të rregullta t’i prezantojë të gjitha pretendimet e

saj lidhur me provat e dorëzuara nga Prokuroria, ashtu siç kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

113. Në dritën e shqyrtimeve dhe arsytetimeve të lartcekura, si dhe duke marrë parasysh parimet e përgjithshme të “barazisë së armëve” dhe “parimin e kontradiktoritetit”, të elaboruara më lart, Gjykata konkludon se janë të pabazuara pretendimet e parashtrueses për cenimin e parimit të “barazisë së armëve” dhe “parimit të kontradiktoritetit”, si rezultat i pamundësisë së qasjes në prova nga Prokuroria gjatë fazës së hetimeve.

ii) Lidhur me të drejtën për të marrë në pyetje dëshmitarin “C”

114. Parashtruesja e kërkesës thekson se asaj i është pamundësuar marrja në pyetje të dëshmitarit “C” dhe rrjedhimisht nuk ka pasur mundësi t’i bëjë pyetje dëshmitarti “C” në asnjë fazë të procedurës pasi deklarata e dëshmitarit “C” vetëm është lexuar në shqyrtimin gjyqësor, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore është nxjerrë bazuar në këtë dëshmi.
115. Gjykata rikujton se kriteret e përgjithshme përkitazi me të drejtën e të akuzuarit për të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij/saj janë elaboruar detajisht përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës KI14/18, parashtrues: *Hysen Kamberi*, Aktgjykim i 15 janarit 2020, paragrafët 47 deri 76, i cili Aktgjykim ka marrë për bazë dy raste të GJEDNJ-së, përkatësisht rasteve *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 15 dhjetorit 2011; dhe *Schatschaschëili kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i 15 dhjetorit 2015.
116. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, duke pasur parasysh se pranueshmëria e dëshmimeve është në parim çështje e rregullimit me ligj dhe e gjykatave vendore, bazuar në paragrafin 1. dhe pikën (d) të paragrafit 3. të nenit 6. të KEDNJ-së, ajo shqyrton vetëm nëse procedurat, në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të drejtë (shih rastin e Gjykatës KI14/18, cituar më lart, paragrafi 46; shih, gjithashtu, rastet e GJEDNJ-së, *Al-Khaëaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 118; *Schatschaschëili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 101; dhe *Seton kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi i 12 shtatorit 2016, paragrafi 57). Këto dispozita, megjithatë ngërthejnë në vetvete prezumimin kundër përdorimit të dëshmimeve jashtëgjyqësore kundër të akuzuarit në një procedurë penale. E njëjta vlen edhe kur një dëshmi e tillë mund të jetë në favor të mbrojtjes (shih rastin e Gjykatës KI14/18, cituar më lart, paragrafi 46).
117. Për më tepër, bazuar në pikën (d) të paragrafit 3. të nenit 6. të KEDNJ-së dhe praktikës përkatëse gjyqësore të GJEDNJ-së, para se një i akuzuar të mund të dënohet, të gjitha dëshmitë kundër tij duhet të paraqiten në praninë e tij në një seancë dëgjimore publike me qëllim të dhënies së mundësisë së kundërshtimit të argumenteve (shih rastin e Gjykatës KI14/18, cituar më lart, paragrafi 47. Shih rastet e GJEDNJ-së *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 118; *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 101; dhe *Seton kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart,

- paragrafi 57). Përjashtimet nga ky parim janë të mundshme, por në asnjë rrethanë, nuk mund të cenohen të drejtat e mbrojtjes, e të cilat, si rregull, kërkojnë që të akuzuarit t'i jepet mundësi adekuate dhe e përshtatshme për të kundërshtuar dhe për të marrë në pyetje dëshmitarin kundër tij, qoftë kur ai dëshmitar e jep deklaratën ose në një fazë të mëvonshme të procedurave (shih rastin e Gjykatës KI14/18, cituar më lart, paragrafi 47; shih rastet e GJEDNJ-së *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 118; *Hümmer kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i 19 korrik 2012, paragrafi 38; *Lucà kundër Italisë*, Aktgjykim i 27 shkurtit 2001, paragrafi 39; Solakov kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Aktgjykim i 31 tetorit 2001, paragrafi 57; dhe *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 105).
118. GJEDNJ, megjithatë, gjithashtu ka theksuar se përdorimi i deklaratave të marra në fazën e hetimeve policore e gjyqësore nuk është në vetvete në kundërshtim me paragrafin 1. dhe pikën (d) të paragrafit 3. të nenit 6. të KEDNJ-së, me kushtin që të drejtat e mbrojtjes të jenë respektuar. Si rregull i përgjithshëm, i akuzuari dhe mbrojtja e tij duhet të kenë mundësi adekuate për të kundërshtuar dhe pyetur dëshmitarin përkatës, ose kur i njëjti ka bërë deklaratën ose në një fazë të mëvonshme të procedurës gjyqësore (shih rastin e Gjykatës KI14/18, cituar më lart, paragrafi 47; shih, gjithashtu, rastet e GJEDNJ-së *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 118; *Trampevski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, Aktgjykim i 10 korrikut 2012, paragrafi 44; dhe *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 105).
119. GJEDNJ gjithashtu ka theksuar se duke marrë parasysh rëndësinë e administrimit të drejtë të drejtësisë në një shoqëri demokratike, çdo masë që kufizon të drejtat e mbrojtjes duhet të jetë rreptësisht e nevojshme. Nëse një masë më pak kufizuese mund të mjaftojë, atëherë ajo duhet të zbatohet (shih rastin e GJEDNJ-së, *Van Mechelen dhe të tjerët kundër Holandës*, Aktgjykim i 23 prillit 1997, paragrafi 58). Mundësia e të akuzuarit që të përballet me dëshmitarët në prani të një gjyqtari është një element qenësor i një procesi gjyqësor të drejtë (shih rastin e Gjykatës KI14/18, cituar më lart, paragrafi 48; shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Taráu kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 24 shkurtit 2009, paragrafi 74).
120. Andaj, GJEDNJ ka theksuar nëse një përjashtim i tillë ndodh atëherë: (i) gjykata përkatëse duhet së pari të shqyrtojë pyetjen paraprake, përkatësisht nëse ka pasur arsye të qëndrueshme për pranimin e dëshmisë së dëshmitarit në mungesë, duke pasur parasysh që, si rregull i përgjithshëm, dëshmitarët duhet të japin dëshmi gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe se duhet të bëhen të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar pjesëmarrjen e tyre; (ii) kur dëshmitari nuk është marrë në pyetje në asnjë fazë të mëparshme të procedurës, pranimi i deklaratës së dëshmitarit në vend të dëshmimeve të drejtpërdrejta në proces gjyqësor duhet të jetë masa e fundit; (iii) pranimi si dëshmi i deklaratave të dëshmitarëve në mungesë rezulton në një disavantazh potencial për të akuzuarin, i cili, në parim, duhet të ketë mundësi efektive për të kundërshtuar dëshmitë kundër tij. Në veçanti, ai duhet të jetë në gjendje të testojë vërtetësinë dhe besueshmërinë e dëshmimeve të dhëna nga dëshmitarët, duke siguruar

marrjen e tyre në pyetje në praninë e tij, qoftë në kohën kur dëshmitari e jep deklaratën ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedurës; (iv) sipas “*rregullit të vetëm ose vendimtar*” (sole or decisive rule), nëse dënimi i të akuzuarit bazohet vetëm ose kryesisht në dëshmi të siguruara nga dëshmitarë të cilët i akuzuari nuk ka patur mundësi t’i marrë në pyetje në ndonjë fazë të procedurës, të drejtat e tij të mbrojtjes janë të kufizuara padrejtësisht; (v) megjithatë, duke marrë parasysh që pika (d) e paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së duhet të interpretohet në kuptim të rregullsisë së përgjithshme të procedurës - “*rregulli i vetëm ose vendimtar*” nuk duhet të zbatohet në mënyrë jofleksibile; dhe (vi) në veçanti, kur një deklaratë jashtëgjyqësore është dëshmia e “*vetme ose vendimtare*” kundër një të akuzuari, pranimi i saj si dëshmi nuk rezulton detyrimisht në shkelje të paragrafit 1. të nenit 6. të KEDNJ-së. Në një rast të tillë megjithatë, procedurat gjyqësore duhet t’i nënshtrohen një kontrolli rigoroz procedural. Për shkak të rreziqeve të pranimit të dëshmimeve të tilla, gjykata përkatëse duhet të bazojë vendimin e saj në faktorë kundërbalancues, duke përfshirë masat që lejojnë një vlerësim të drejtë dhe të duhur të besueshmërisë së dëshmisë përkatëse. Kjo do të lejonte që një dënim të bazohet në dëshmi të tilla vetëm nëse ato janë mjaftueshëm të besueshme (shih rastin e Gjykatës KI14/18, cituar më lart, paragrafi 51).

121. Ndërsa, përkitazi me testin e zhvilluar në rastin *Al-Khawaja and Tahery*, për të vlerësuar përputhshmërinë me garancitë e mishëruara në pikën (d) të paragrafit 3. të nenit 6. të KEDNJ-së, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, është e nevojshme të shqyrtohen tri çështje themelore, në çdo rast kur deklaratat e dëshmitarëve që kanë munguar në shqyrtim gjyqësor janë pranuar si dëshmi në gjykatë. Gjykata duhet të shqyrtojë nëse: (i) ka pasur arsye të qëndrueshme për mospjesëmarrjen e dëshmitarit në shqyrtim gjyqësor dhe për pasojë, pranimin e dëshmive jashtëgjyqësore të dëshmitarit në mungesë si dëshmi në gjykatë; (ii) dëshmia e dëshmitarit në mungesë është baza e “*vetme ose vendimtare*” për dënimin e të akuzuarit; dhe (iii) ka faktor të mjaftueshëm kundërbalancues, duke përfshirë garancione të forta procedurale, në mënyrë që të kompensohet disavantazhi i mbrojtjes si rezultat i pranimit të dëshmisë jashtëgjyqësore dhe për të siguruar që gjykimi, në tërësinë e tij, ka qenë i drejtë (shih rastin e Gjykatës KI14/18, cituar më lart, paragrafi 52; shih, gjithashtu, rastet e GJEDNJ-së *Schatschaschëili kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 107; dhe *Seton kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 58). Gjykata në vijim do t’i shtjellojë më detajisht të tri çështjet e identifikuar.

Aplikimi i këtyre parimeve në rastin konkret

122. Duke pasur parasysh parimet e lartcekura lidhur me të drejtën e të akuzuarit për të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij/saj, Gjykata në vazhdim do të vlerësojë zbatimin e parimeve të lartcekura në rastin konkret, për të përcaktuar nëse pamundësia për të marrë në pyetje dëshmitarin “C” në shqyrtim gjyqësor, ka rezultuar në shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë.

123. Gjykata vëren se çështjen e pamundësisë për të marrë në pyetje dëshmitarin “C” në seancë shqyrtuese para Gjykatës Themelore parashtuesja e kërkesës e kishte ngritur edhe para Gjykatës së Apelit dhe para Gjykatës Supreme.

124. Në këtë aspekt, Gjykata Supreme kishte theksuar se:

“[...] ky pretendim i mbrojtjes është i pabazuar, kjo për faktin se si rezulton nga procesverbali i datës 09.06.2016, me të cilin dëshmitari C është marruar në pyetje nga Prokurori i Prokurorisë Speciale të Kosovës, kane qenë prezentë edhe mbrojtësit e të [parashtrueses së kërkesës], ndërsa [parashtruesja e kërkesës] ka munguar dhe pse e njëjta ka qenë e njoftuar për seancë me ç’rast të gjitha palëve që ishin prezent iu është tërhequr vërejtja se dëshmitari C do të ketë cilësinë e dëshmitarit të mbrojtur, andaj prokurorja ka vazhduar me marrjen në pyetje të të njëjtit, mirëpo mbrojtësit vetë janë larguar nga seanca me arsyetimin se nuk i dihet statusi i dëshmitarit të dëgjuar [...]

Në pajtim me nenin 338 të KPPK, është e rregulluar çështja e leximit të deklaratave të tjera të dhëna me parë, par. 1 pika 1.1, kur personat e marrë në pyetje kane vdekur, kane çrregullime ose paaftesi mendore, nuk mund të gjenden ose ardhja e tyre në gjykatë është e pamundur apo dukshëm e vështirësuar për shkak të pleqërisë, sëmundjes ose shkaqeve të tjera të rëndësishme. Edhe në rastin e kësaj çështjeje penalo juridike sigurimi i prezencës së dëshmitarit C në seancën e shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës ka qenë i pamundshëm, andaj gjykata e ka lexuar deklaratën e këtij dëshmitari të dhënë më parë në procedurën paraprake dhe për këtë ka dhënë arsyetimin, dhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate leximi i deklaratës së dëshmitarit C nuk ka ndikuar në ligjshmërinë e marrjes së vendimit gjyqësor, prandaj edhe pretendimi i mbrojtjes është i pabazuar

[...]

“aktgjykimi i shkallës së parë kur [parashtruesen e kërkesës] e ka shpallur fajtores është bazuar në prova materiale –transkripte të takimit të zhvilluar në mes të [parashtrueses së kërkesës] dhe dëshmitarit C [...] Përveç me këto prova, nga shkresat e lëndës rezulton se [Gjykata Themelore] aktgjykimin e mbështet edhe në dëgjimin e dëshmitarëve [...] deklaratën e dëshmitarit C [...] dhe prova të tjera materiale [...].”

[...]

Pretendimi i mbrojtjes se dëshmitarit C nuk i dihet "cilësia", sipas vlerësimit të kësaj gjykate është i pabazuar, për faktin se për këtë pretendim është dhënë arsyetimi edhe nga gjykatat e instancës me të ulët se me urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake PPS.8/2015 të datës 31.05.2016, dëshmitarit i është caktuar pseudonimi dëshmitari C, ndaj te cilit janë aplikuar masat mbrojtëse, të cilit i është njohur cilësia si dëshmitar i mbrojtur me pseudonimin dëshmitari C, e nuk bëhet fjalë as për dëshmitar bashkëpunues e as si dëshmitar, por bëhet fjalë për dëshmitarin e mbrojtur me pseudonimin dëshmitari C.”

125. Duke pasur parasysh arsyetimin e lartcekur të Gjykatës Supreme, Gjykata vëren se lidhur me dëshmitarin “C”: a) parashtuesja e kërkesës ka qenë e informuar se ai është dëshmitar i mbrojtur me vendim gjyqësor; b) ajo dhe mbrojtësit e saj

kanë qenë të ftuar gjatë fazës hetimore kur është marrë në pyetje ai dëshmitar por mbrojtësit e saj kanë refuzuar që të marrin pjesë; dhe c) dëshmia e dhënë nga dëshmitari “C”, e lexuar në shqyrtimin kryesor nuk ka qenë vendimtare për shpalljen fajtores të parashtrueses pasi Aktgjykimi i Gjykatës Themelore është mbështetur në biseda që parashtruesja e kërkesës ka pasur me dëshmitarin “C”, dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë si dhe prova të tjera materiale..

126. Andaj, duke pasur parasysh të lartcekurat, Gjykata vlerëson se (i) parashtrueses së kërkesës/mbrojtësve të saj, i është dhënë mundësia të jenë të papranishëm dhe ti parashtrojnë pyetje dëshmitarit C, në një fazë të mëhershme të procedurës, por nuk e kanë shfrytëzuar një mundësi të tillë dhe se për më tepër (ii) fakti që dëshmia e dëshmitarit “C” është lexuar në shqyrtim gjyqësor, nuk ka ndikuar që procedura gjyqësore ndaj parashtrueses së kërkesës të konsiderohet që në tërësinë e saj nuk ka qenë e drejtë ashtu si parashihet me të drejtën për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ, pasi fajësia e saj është vërtetuar edhe me prova të tjera, andaj ajo dëshmi nuk ka qenë *“e vetmja dhe vendimtare”* lidhur me rastin e saj.
127. Rrjedhimisht, edhe ky pretendim i parashtrueses është i pa bazuar.

iii) Lidhur me papranueshmërinë e provave, përdorimin e SMS-ve retroaktiv në procedurën penale ndaj saj

128. Lidhur me këtë, parashtruesja e kërkesës pretendon se aktgjykimet lidhur me dënimin e saj penal janë bazuar në prova të papranueshme, konkretisht në SMS të nxjerrë në mënyrë retroaktive duke shkelur kështu, përveç të drejtës për jetë private, lidhur me të cilën Gjykata konstatoi shkelje, edhe të drejtën për gjykim të drejtë. Andaj, parashtruesja e kërkesës konteston specifikisht përgjimet që ishin bërë para nxjerrjes së Urdhrit [PP. 51/2014] të 4 qershorit 2014. Andaj, Gjykata do të vlerëson nëse si rezultat i këtyre përgjimeve parashtrueses përveç të drejtën për privatësi që u konstatua nga Gjykata më lart, i ishte shkelur po ashtu e drejta për një gjykim të drejtë.

Parimet e përgjithshme në bazë të praktikës gjyqësore të Gjykatës, si dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së lidhur me pranueshmërinë e provave në procedurë

129. Përkitazi me çështjet që ndërlidhen me paraqitjen e provave dhe pranueshmërinë e tyre, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së e cila, në parim ka theksuar se *“[n]donëse neni 6 e garanton të drejtën për një proces të rregullt, ai megjithatë nuk përcakton rregulla për pranueshmërinë e provave si të tillë, një fushë kjo që u përket për këtë arsye në radhë të parë të drejtës së brendshme dhe juridiksioneve kombëtare”* (shih rastet e GJEDNJ-së *Schenk kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 12 korrikut 1988, paragrafët 45-46 dhe *Heglas kundër Republikës Çeke*, Aktgjykim 1 mars 2007, paragrafi 84). Gjykata vë theksin në qëndrimin e saj parimor se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve apo të ligjit (ligjshmëria), që

pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme apo ndonjë gjykatë tjetër e instancës më të ulët, përveç; nëse dhe për aq sa ajo mund të ketë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria) (shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI128/18, parashtrues: *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A., "Adem Jashari"*, Aktvendim i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; KI62/19, parashtrues: *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; KI110/19, parashtrues: *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, paragrafi 40).

130. Përderisa e neni 6 i KEDNJ dhe neni 31 i Kushtetutës garanton të drejtën për gjykim të drejtë, kjo nuk përcakton ndonjë rregull sa i përket pranueshmërisë së provave si të tilla, të cilat janë në radhë të parë çështje që rregullohen me të drejtën e brendshme, Ashtu si ka nënvizuar edhe GJEDNJ, nuk është roli i Gjykatës në kuadër të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, për të vendosur nëse, parimisht, një provë e caktuar, për shembull, prova e marrë në mënyrë të paligjshme, duhet të jetë e pranueshme apo jo, apo në të vërtetë nëse parashtruesi është fajtor apo jo lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet (shih, *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së *Dragojević kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 15 prillit 2015, paragrafët 127 dhe 128; *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 118; dhe *Bykov kundër Rusisë*, Aktgjykim i 10 prill 2009, paragrafi 88).
131. Aspekti që duhet shqyrtuar në këto raste është nëse procedura, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë mbledhur provat, ka qenë e rregullt në tërësinë e saj (shih rastin e Gjykatës KI230/19, cituar më lart, paragrafi 102; shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 12 maj 2000, paragrafi 34; *P.G. e J.H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 25 shtatorit 2001, paragrafi 76; dhe *Allan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 5 nëntorit 2002, paragrafi 42).
132. Në këtë kontekst, për të vlerësuar nëse procedura në tërësinë e saj, ka qenë e drejtë, rëndësi duhet ti kushtohet nëse të drejtat e mbrojtjes janë respektuar. Pra në këtë kontekst, duhet të vlerësohet nëse veçanërisht parashtruesit i është dhënë mundësi që të sfidojnë autenticitetin e provave dhe për të kundërshtuar përdorimin e tyre. Për më tepër, kualiteti i provave duhet të merret parasysh, duke përfshirë, mënyrën në të cilën janë marrë këto prova, dhe nëse kjo paraqet dyshim sa i përket besueshmërisë dhe saktësisë së tyre. Përderisa nuk mund të thuhet që mund të vjen në shprehje domosdoshmërisht çështja e një gjykimi të drejtë kur prova e marrë është e mbështetur me materiale tjera, duhet të theksohet se kur prova është shumë e fortë, dhe nuk ka rrezik që një provë e tillë të jetë e pabesueshme, atëherë nevoja për prova mbështetëse, është më e vogël (shih rastet e GJEDNJ-së *Boykov kundër Rusisë*, cituar më lart, paragrafi 90; *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 35 dhe 37; dhe *Allan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 43).
133. Andaj për të konstatuar nëse në një rast të caktuar mund të ketë shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë, është e rëndësisë thelbësore për konstatimin

nëse prova e marrë në mënyrë të paligjshme, ka qenë provë e vetëm dhe vendimtare lidhur me rastin konkret.

Aplikimi i këtyre parimeve në rastin konkret

134. Në aplikimin e këtyre parimeve në rastin konkret, përkatësisht lidhur me pretendimin se aktykimet e kontestuara janë mbështetur në prova të cilat kanë qenë ligjrisht të papranueshme, konkretisht në SMS-të të cilët janë nxjerrë në mënyrë retroaktive, Gjykata duhet të vlerësoj mënyrën e trajtimit të provave dhe rëndësinë e këtyre provave në shpalljen fajtor të parashtrueses së kërkesës, duke marrë për bazë procedurën si tërësi, dhe nëse këto prova kanë qenë vendimtare për shpalljen fajtoresh të parashtrueses së kërkesës apo jo.
135. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës kishte paraqitur kundërshtimin e saj lidhur me marrjen e SMS-ve në mënyrë retroaktive, në dy procedura gjyqësore Atë për kundërshtimin e aktakuzës dhe procedurën penale lidhur me shpalljen fajtor të saj, duke ngritur çështjen e rëndësisë së këtyre provave në shpalljen fajtoresh të saj. Të gjitha instancat gjyqësore kishin trajtuar këtë pretendim të parashtrueses së kërkesës duke dhënë arsyetimin se pse këto prova nuk kanë ndikuar në shpalljen fajtor të parashtrueses së kërkesës.
136. Në rastin konkret, lidhur me rëndësinë e SMS-ve të marrë në mënyrë retroaktive, Gjykata Supreme, përfundimisht kishte arsyetuar se *“nuk qëndrojnë pretendimet e mbrojtësve të [parashtruesës së kërkesës] se Aktgjykimi i [Gjykatës Themelore] është bazuuar në prova të papraneueshme, nga arsyeja se aktykimet i shkallës së parë kur [parashtruesen e kërkesës] e ka shpallur fajtoresh është bazuuar në prova materiale –transkripte e takime të zhvilluar në mes të [parashtruesës së kërkesës] dhe dëhmitarit C [...]. Përveç me këto prova, nga shkresat e lëndës rezultojnë se aktykimet e mbështetur edhe në dëgjimin e dëhmitarëve në shqyrtimin gjyqësor [...] deklaratën e dëhmitarit C [...] dhe prova të tjera materiale [...]”* (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së *Dragojević kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 15 prillit 2015, paragrafi 133).
137. Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e saj, e ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga prokuroria, duke përfshirë SMS-ët retroaktiv. Gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e saj shikuar objektivisht, që kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës, arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar janë paraqitur në detaje, prandaj, procedura, shikuar në tërësi, ishte e drejtë. (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI22/19, parashtrues: *Sabit Ilazi*, aktvendim i 7 qershorit 2019, paragrafi 42 si dhe rastin e Gjykatës KI128/18, cituar më lart, paragrafi 58). Fakti që procedurat e ndjekura nuk kanë qenë të suksesshme nuk ndikon në këtë konkluzion të Gjykatës.

138. Për më tepër, pretendimi se aktgjykimi i Gjykatës Themelore është mbështetur në prova të papranueshme, nuk është i bazuar, pasi SMS-ët e marrë në mënyrë retroaktive nuk kanë qenë bazë e vetme dhe as vendimtare për shpalljen fajtores të parashtrueses së kërkesës. Kjo pasi, Gjykata gjen se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, i konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme, është mbështetur në prova të tjera materiale e dëshmi të dëshmitarëve, mes tjerash, (i) dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë; (ii) transkriptet e takimit të zhvilluar në mes të parashtrueses së kërkesës dhe dëshmitarit C, biseda të zhvilluara më datë 30 mars 2016 dhe 24 prill 2016, të cilat ishin bërë duke u bazuar në masa të fshehta të autorizuara në mënyrë të ligjshme sipas Urdhrit të datës 25 mars 2016, të Gjykatës Themelore për aplikimin e masës së fshehtë të fotografimit apo video vëzhgimit, monitorimin e fshehtë të bisedave dhe stimulimin e korrupsionit për sa i përket parashtrueses së kërkesës dhe të akuzuarve të tjerë, gjatë të cilave takime parashtruesja e kërkesës kishte pranuar se nga dëshmitari “C” ka marrë shuma të caktuara të parave; si dhe (iii) raportet e përgjimeve, mes tjerash, të datave 31 maj 2016 dhe 1 qershor 2016, për të cilat nuk janë argumentuar se ishin bërë në mënyrë retroaktive dhe të paligjshme.
139. Andaj, Gjykata gjeti se, megjithëse kishte shkelje të së drejtës për privatësi si rezultat i marrjes së SMS-ve në mënyrë retroaktive, pretendimi se aktgjykimet e gjykatave të rregullta kanë shkelur po ashtu të drejtën për një gjykim të drejtë nuk qëndrojnë, pasi këto prova nuk kanë ndikuar që procedurat, marrë në tërësinë e tyre, të kenë qenë të padrejta, për faktin që (i) parashtruesja kishte mundësi, megjithëse pa sukses që të sfidonte këto prova gjatë procedurave gjyqësore; dhe për më tepër këto (ii) prova nuk ishin prova të vetme dhe vendimtare për shpalljen fajtores të parashtrueses së kërkesës, pasi aktgjykimet e gjykatave të rregullta janë bazuar në prova tjera të cekura më lart.
140. Një qasje të ngjashme kishte marrë edhe GJEDNJ në rastin para saj *Dragojević kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 15 prillit 2015, cituar më lart tek parime e përgjithshme, me ç’rast kjo e fundit kishte konstatuar shkelje të së drejtës për privatësi për shkak të masave të fshehta të urdhëruara në mënyrë kundërligjshme, ndaj parashtruesit të kërkesës. Megjithatë, sa i përket pretendimeve për shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë, si rezultat i masave të fshehta të urdhëruara ndaj parashtruesit të kërkesës, GJEDNJ nuk kishte konstatuar shkelje për faktin që kishte ardhur në përfundim se parashtruesi (i) kishte pasur mundësi që ti sfidoj ato prova gjatë procedurës penale, megjithëse pa sukses; dhe (ii) provat e marra përmes masave të fshehta nuk kishin qenë të vetmet prova me të cilat ishte dëshmuar fajësia e parashtruesit të kërkesës lidhur me akuzën penale, pasi akuza penale ndaj tij ishte dëshmuar edhe me prova të tjera.
141. Në këtë kontekst edhe në rastin *Dragos Ioan Rusu kundër Rumanisë*, GJEDNJ gjeti se korrespondenca në fjalë lidhur me të cilën GJEDNJ gjeti shkelje të së drejtës për privatësi të garantuar me nenin 8 të KEDNJ, nuk ishte më tepër se një pjesë e tërësisë së provave të vlerësuara nga gjykata, e cila po ashtu përfshinte vlerësimin e përmbajtjes së saj dhe shkrimin në zarf, transkriptet e vëzhgimit audio dhe video, deklaratat e dëshmitarëve, raporteve policore, e të tjera. Andaj, pas vlerësimit të masave siguruese lidhur me vlerësimin dhe

pranueshmërinë e provave në fjalë dhe përdorimin e tyre, GJEDNJ erdhi në përfundim se procedura, shikuar në tërësinë e saj, ishte e drejtë, andaj konstatoi se nuk kishte shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së, *Dragos Ioan Rusu kundër Rumanisë*, paragrafët 55 dhe 56).

142. Ngjashëm edhe në rastin *Boykov kundër Ruisë*, GJEDNJ megjithëse konstatoi shkelje të së drejtës për privatësi të garantuar nga neni 8 i KEDNJ, lidhur me përgjimet e telefonit të parashtruesit të kërkesës, lidhur me atë nëse po ashtu kishte shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë, GJEDNJ gjeti se ky nuk ishte rasti pikërisht duke u bazuar në faktin se provat e marra nga përgjimet, të cilat GJEDNJ i deklaroi në kundërshtim me nenin 8 të KEDNJ-së, nuk ishin të vetmet prova për dënimin e parashtruesit, pasi fajësia e tij ishte vërtetuar edhe me prova të tjera (shih rastin e GEDNJ-së *Bykov kundër Ruisë*, cituar më lart, paragrafi 98).
143. Rrjedhimisht, në dritën e shqyrtimeve dhe arsyetimeve të lartcekura, si dhe duke marrë parasysh parimet e përgjithshme lidhur me provat e administruara në procedure penale, të elaboruara më lart, Gjykata gjen se edhe në rastin konkret, marrja e SMS-ve në mënyrë retroaktive nuk i ka mohuar, si e tillë, parashtrueses së kërkesës të drejtën për një gjykim të drejtë, pasi ajo ishte dënuar për veprën penale për të cilën akuzohej bazuar edhe në prova të tjera të cilat ose nuk ishin kontestuar para kësaj Gjykate ose Gjykata nuk ka konstatuar shkelje Andej Gjykata konstaton se procedurat lidhur me shpalljen fajtores të parashtrueses, marrë në tërësinë e tyre, kanë qenë të drejta.
144. Për më tepër, parashtruesja e kërkesës pretendon edhe shkelje të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, nenit 13 (e drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, dhe nenit 8 të DUDNJ-së. Duke pasur parasysh gjetjen e Gjykatës së përcaktuara më lart sa i përket shkeljes së të drejtës për jetë private, nuk është e nevojshme të shqyrtohen ndaras pretendimet e saj për shkelje të nenit 13 (e drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, dhe nenit 8 të DUDNJ-së.

Efektet e këtij Aktgjykimi për parashtruesen e kërkesës

145. Gjykata ka parasysh faktin se parashtruesja e kërkesës është shpallur fajtores dhe është dënuar me burgim përmes Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda [PKR.nr.484/2016], të 18 nëntorit 2019, të konfirmuar nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme, në kuadër të procedurës penale të zhvilluar kundër saj. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se ajo nuk ka gjetur shkelje në procedurat lidhur me shpalljen e saj fajtores për veprat penale për të cilat akuzohej, dhe se efektet e këtij Aktgjykimi shtrihen vetëm në pjesën e kërkesës lidhur me shkeljen të së drejtës për privatësi si rezultat i autorizimit të leximit të SMS-ve në mënyrë retroaktive. Andaj, është e kuptueshme që ky Aktgjykim nuk mund të prodhojë asnjë efekt në lidhje me statusin e parashtrueses së kërkesës si e dënuar për vepër penale që ndërlihet me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme të Kosovës Pml.nr.29/2021, i 13 prillit 2021, i cili mbetet në fuqi.

146. Megjithatë, Gjykata vlerëson se është shumë e rëndësishme që përmes këtij Aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese do të vendoset një standard i ri në praktikën gjyqësore në Republikën e Kosovës dhe, rrjedhimisht gjykatat e rregullta, në të ardhmen do të duhet të veprojnë në përputhje me parimet dhe standardet e elaboruara në këtë Aktgjykim lidhur me përgjimet telefonike dhe leximin retroaktiv të përmbajtjes së masazheve SMS, të cilat janë interpretuar në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.
147. Në këtë kontekst, Gjykata përmes këtij Aktgjykimi përçon në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë kërkesën dhe udhëzimin që duhet t'iu shërbejë gjykatave të rregullta, për të qenë në përputhje me kërkesat kushtetuese të nenit 36 të Kushtetutës, dhe po ashtu edhe me kërkesat e nenit 8 të KEDNJ-së, siç është interpretuar gjerësisht nga GJEDNJ në praktikën e saj gjyqësore.
148. Gjykata, më tej sqaron se nuk ka autorizime ligjore për caktimin e ndonjë lloji apo mënyre të kompensimit për rastet kur konstatohet shkelje të dispozitave respektive kushtetuese, në rastin konkret nenit 36 të Kushtetutës (shih rastet e Gjykatës: KI10/18, parashtrues *Fahri Deçani*, Aktgjykim i 8 tetorit 2019, paragrafi 119; dhe KI108/18, parashtruese *Blerta Morina*, Aktvendim për papranueshmëri i 1 tetorit 2019, paragrafi 196).
149. Gjykata po ashtu rikujton që në praktikën e GJEDNJ-së, bazuar në rrethanat specifike të rastit, GJEDNJ konsideron se vet gjetja e shkeljes paraqet një lloj të "shpërblim të drejtë" edhe për dëmin jo-material që një parashtrues mund të ketë pësuar (shih, në lidhje me këtë, rastin KI10/18, cituar më lart, paragrafi 119; shih gjithashtu, pjesën operative të rastit të GJEDNJ-së, *Roman Zaharov kundër Rusisë*, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2015; shih po ashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese KI108/18, parashtruese *Blerta Morina*, paragrafi 197).
150. Megjithatë, dhe për më tepër Gjykata ka theksuar se individët kanë të drejtë të kërkojnë përmes inicimit të një procedure të ndarë për dëmshpërblim nga autoritetet publike në rast të konstatimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të tyre të bazuara në ligjet e zbatueshme në Republikën e Kosovës (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese KI10/18, cituar më lart, paragrafi 120; dhe KI108/18, parashtruese *Blerta Morina*, Aktvendim për papranueshmëri i 1 tetorit 2019, paragrafi 197).
151. Andaj, në rastet kur vetëm konstatimi i shkeljes kushtetuese nga Gjykata Kushtetuese mund të mos jetë i mjaftueshëm për të evituar pasojat e shkeljes kushtetuese dhe kur kompensimi monetar është i domosdoshëm, i'u takon palëve të përfshira në rast që të shfrytëzojnë mjetet juridike në dispozicion sipas legjislacionit në fuqi, për realizimin e mëtejme të të drejtave të tyre, duke përfshirë edhe të drejtën për të kërkuar kompensimin e dëmit material, si rezultat e shkeljeve të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, të konstatuara nga Gjykata Kushtetuese, duke përfshirë shkeljen e të drejtës për jetë private të garantuar me nenin 36 të Kushtetutës dhe nenin 8 të KEDNJ-së.

Kërkesa për masë të përkohshme

152. Gjkata rikujton se parashtruesja e kërkesës, gjithashtu kërkon nga Gjkata që të nxjerrë masën e përkohshme për pezullimin e zbatimit të vendimeve të lartcekura, *“sepse një zbatim i këtyre aktgjykimeve të cilat konsiderohen antikushtetuese do ta privonte parashtruesen nga liria dhe do ti shkaktonte dëme të pariparueshme për jetën dhe shëndetin e saj”*.
153. Gjkata e shpalli kërkesën të pranueshme dhe gjeti shkeljet e specifikuar në dispozitiv të këtij Aktgjykimi. Kjo vendimmarrje e bën më tutje të panevojshme shqyrtimin e kërkesës për masë të përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjkata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20, 27 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, më 20 dhjetor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË SHPALLË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TË KONSTATOJË se nuk ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- IV. TË KONSTATOJË se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Pml.nr.29/2021, i 13 prillit 2021, mbetet në fuqi.
- V. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- VI. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- VII. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani